



Përmbledhje e Politikave: Ekonomizimi, financimi dhe qeverisja e Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë

**ADAPT: Zgjidhje të Bazuara në Natyrë
për Shoqëritë me Aftësi Ripërtëritëse
në Ballkanin Perëndimor**

IUCN ECARO

Përmbledhja e politikave: Ekonomia e Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë

**ADAPT: Zgjidhje të Bazuara në Natyrë për shoqëritë me
aftësi ripërtëritëse në Ballkanin Perëndimor**

IUCN ECARO

Autor:

Alexander Bisaro

Recensentë:

Mihaela Dragan-Lebovics, Kristin Meyer, Leander Raes

Hyrje	4
Mesazhi kyç: metodat e vlerësimit ekonomik duhet të zbatohen sistematikisht kur vlerësohen projektet ZBN ose ato hibride.	6
Mesazhi kyç: vlerësimi ekonomik i ZBN-ve për PNK/ RRF përfshin një numër metodash të ndryshme dhe zgjedhja e metodave të përshtatshme është një detyrë thelbësore	7
Qasje për vlerësimin ekonomik të ZBN-ve për PNK dhe RRF	8
Analiza kosto-përfitim (AKP).....	8
Shembull: analiza kosto-përfitim e opsioneve të restaurimit të peizazhit pyjor në Kraljevo, Serbi	9
Analiza e efektivitetit të koston (AEK) e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe opsionet MRF.....	13
Shembull: analiza e efektivitetit të koston për biodiversitetin e kullotave në Finlandë	14
Mesazhi kyç: metodat e vlerësimit ekonomik janë mjete veçanërisht të rëndësishme për të ofruar një pamje të plotë të përfitimeve nga ZBN-të	15
Mesazhi kyç: metodat e normës së skontimi janë gjithashtu thelbësore sepse shumë ZBN ofrojnë përfitime që grumbullohen gjatë periudhave më të gjata kohore	17
Shembull: analiza kosto-përfitim e ZBN-ve për menaxhimin e kullotave në Canchayllo, Peru	18
Referencat	21
Burime të mëtejshme	21

Mesazhet kyçe

Metodat e vlerësimit ekonomik duhet të zbatohen sistematikisht kur vlerësohen projektet ZBN ose ato hibride.

Masat ZBN ofrojnë përfitime të shumta të përbashkëta dhe shpesh kërkojnë kosto më të ulët për t'u zbatuar në krahasim me shumë masa konvencionale për të adresuar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (PNK) ose reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë (RRF). Prandaj, aplikimi sistematik i metodave të vlerësimit ekonomik nuk është vetëm praktikë e mirë për vendimmarrje dhe politikë-bërje në përgjithësi, por duhet të ofrojë gjithashtu një kuadër logjik të bazuar mirë për zgjedhjen e zgjidhjeve ZBN ose atyre hibride për të adresuar PNK-në dhe RRF-në.

Vlerësimi ekonomik i ZBN-ve për PNK/RRF përfshin një sërë metodash të ndryshme dhe zgjedhja e metodave të përshtatshme është një detyrë thelbësore.

Përzgjedhja se cila metodë e vlerësimit ekonomik është e përshtatshme për një vendim të veçantë të PNK-së varet nga disa faktorë. Këta faktorë përfshijnë përgjithësisht harkun kohor të opsioneve të shqyrtuara, vështirësitë e rrezikut të vendimmarrësve dhe njohuritë (p.sh. disponueshmërinë e të dhënave) ose pasigurinë në lidhje me klimën e ardhshme dhe rezultatet e masave të përshtatjes. Metodatat e analizës kosto-përfitim zbatohen më së miri kur opsione dhe rezultate të ndryshme mund të modelohen zyrtarisht dhe të konvertohen në një metrikë të vetme (monetare) në vlerësim. Për vendimet që përfshijnë rezultate ku nuk është e dëshirueshme të konvertohen në një metrikë të vetme, p.sh. që përfshin vdekshmërinë ose pragjet për humbjen e pakthyeshme të biodiversitetit, ose të përealizueshme për shkak të kufizimeve të burimeve ose të dhënave, mund të përdoren metoda të tjera, të tilla si, efektiviteti i koston ose analiza me shumë kritere mund të jetë e përshtatshme.

Metodat e vlerësimit ekonomik janë mjete veçanërisht të rëndësishme për të ofruar një pamje të plotë të përfitimeve

nga ZBN-të gjatë gjithë harkut kohor të ndërhyrjes. Vlerësimi monetar është i rëndësishëm për ZBN-të për shkak të përfitimeve të shumta të përbashkëta që sjellin ZBN-të dhe konvertimi i këtyre përfitimeve në vlera monetare është thelbësor për të krijuar një pamje të plotë të përfitimeve që sjellin ZBN-të në procesin e vlerësimit ekonomik. Për më tepër, ZBN-të priren të ofrojnë përfitime për periudha më të gjata kohore dhe metodat e vlerësimit duhet të bëjnë pjesë në këtë shtrirje kohore afatgjatë. Mjetet veçanërisht të rëndësishme për vlerësimin e përfitimeve të përbashkëta të prodhuara zakonisht nga ZBN-të janë, për shembull, metodat e vlerësimit të kushtëzuar (të bazuar në anketime) dhe metodat hedonike (kuantifikuese) të përcaktimit të çmimit. Më tej, metoda të tjera të vlerësimit janë gjithashtu të rëndësishme (IBPES, 2022)

Metodat e normës së skontimit janë gjithashtu thelbësore sepse shumë ZBN ofrojnë përfitime që grumbullohen gjatë periudhave më të gjata kohore që shkojnë përtej ndërhyrjeve tipike të bazuara në projekte, të kufizuara në kohë dhe në shkallë të vogël,

të ngjashme me përshtatjen klimatike në përgjithësi. Për më tepër, ndryshe nga masat më konvencionale të PKN-së, grupi i plotë kumulativ i përfitimeve që rrjedhin nga ZBN-të për masat PKN mund të shfaqet vetëm me kalimin e kohës për shkak të kohës së nevojshme për të përfunduar masa të tilla si restaurimi i peizazhit, ripyllëzimi, etj. Ky aspekt i jep edhe më shumë rëndësi nevojës për aplikim gjithëpërfshirës të metodave të vlerësimit. Këtu, është e rëndësishme të zgjidhen normat e përshtatshme të skontimit që pasqyrojnë vlerën e ruajtjes, restaurimit dhe menaxhimit të biodiversitetit gjatë periudhave të gjata kohore, veçanërisht sepse aspektet e ndërlidhjes së brezave të ndryshëm janë gjithashtu në diskutim (Stern, 2006).

Metodat e vlerësimit ekonomik duhet të integrohen në politika, sepse ato ofrojnë një bazë të shëndoshë për hartimin dhe zbatimin e ZBN-ve.

Për më tepër, vlerësimi i ZBN-ve përmes metodave të vlerësimit ekonomik përputhet plotësisht me Standardin Global të IUCN-së për Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (Kriteri 4: Realizueshmëria ekonomike), dhe kështu siguron një bazë të fortë për mobilizimin e financave për ZBN-të.

Hyrje

Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZBN) po fitojnë rëndësi në mbarë botën si masa me kosto të mundshme efektive që ofrojnë njëkohësisht përfitime mjedisore, sociale dhe ekonomike dhe ndihmojnë në ndërtimin e aftësisë ripërtëritëse. Në të vërtetë, gjatë Asamblesë së Mjedisit të Kombeve të Bashkuara, mbajtur në Nairobi në vitin 2022, liderët botërorë miratuan një rezolutë mbi Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë për Mbështetjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Rezoluta u bën thirrje shteteve anëtare të mbështesin zbatimin e ZBN-ve në partneritet me komunitetet vendore, gratë, të rinjtë dhe popujt indigjenë dhe aplikimin e një qasjeje të drejtuar nga vendi, të përgjigjshme gjinore, pjesëmarrëse dhe plotësisht transparente. ZBN-të shpesh përshkruhen si opsionet e duhura që sjellin përfitime për njerëzit në një sërë skenarësh (Seddon et al., 2019). Në të vërtetë, ZBN-të ofrojnë potencial për të sjellë karakteristika dhe procese të ndryshme natyrore në qytete, peizazhe tokësore dhe detare, dhe adresojnë një sërë sfidash shoqërore, duke përfshirë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë (Seddon et al., 2020).

ZBN-të janë veçanërisht tërheqëse për shkak të gamës së përfitimeve të përbashkëta që ato sjellin, të cilat mund të përmbushin objektiva të shumta sociale, ekonomike dhe politike në një sërë sektorësh dhe shkallësh. Në të vërtetë, njohja e këtyre përfitimeve të ndryshme të përbashkëta dhe përfshirja e duhur e tyre në hartimin e politikave dhe projekteve është thelbësore për rritjen e përfshirjes dhe integritet të ZBN-ve si një përgjigje për të adresuar si përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike ashtu edhe menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Analiza ekonomike dhe vlerësimi i opsioneve PNK/DRM që llogarit gjithë gamën e përfitimeve të përbashkëta nga ZBN-të mund të rrisë ndërgjegjësimin e politikë-bërësve dhe vendimmarrësve për tërheqjen relative të masave ZBN në krahasim me zgjidhjet konvencionale ose 'gri'.

Kjo Përmbledhje e Politikave diskuton analizën ekonomike të ZBN-ve për PNK/RRF duke paraqitur metodat e vlerësimit ekonomik në PNK/RRF duke përfshirë analizën kosto-përfitim dhe kosto-efektivitet, dhe i ilustron këto përmes rasteve studimore të ZBN-ve. Më tej, ajo diskuton çështjet kyçe të vlerësimit dhe skontimit në vlerësimin ekonomik, duke eksploruar gamën e plotë të përfitimeve të përbashkëta të ZBN-ve të rëndësishme për t'u përfshirë në një analizë të tillë dhe rëndësinë e tyre me analizën ekonomike të ZBN-ve në kontekstin e Ballkanit Perëndimor.

Përkufizimet kyçe

Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZBN) janë veprime për të mbrojtur, menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe restauruar ekosistemet natyrore ose të modifikuara, që adresojnë sfidat shoqërore në mënyrë efektive dhe të përshtatur, duke siguruar njëkohësisht mirëqenien njerëzore dhe përfitimet nga biodiversiteti (IUCN, 2016).

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është procesi i përshtatjes me klimën aktuale ose të pritshme dhe pasojat prej saj. Në sistemet njerëzore, përshtatja kërkon të zbusë ose shmangë dëmin, ose të shfrytëzojë mundësitë e dobishme. Në disa sisteme natyrore, ndërhyrja njerëzore mund të lehtësojë përshtatjen me klimën e pritur dhe pasojat prej saj (IPCC, 2014).

Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë ka për qëllim parandalimin e rrezikut të ri dhe reduktimin e rrezikut ekzistues të fatkeqësive (ekspozimi, rreziku ose cenueshmëria) dhe menaxhimin e rrezikut të mbetur, të gjitha këto kontribuojnë në forcimin e elasticitetit dhe rrjedhimisht në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm (IPCC, 2014; UNISDR, 2017).

Mesazhi kyç: Metodatat e vlerësimit ekonomik duhet të zbatohen sistematikisht kur vlerësohen projektet ZBN ose ato hibride.

Metodat e vlerësimit ekonomik mund të zbatohen në mënyrë të dobishme për të mbështetur vendimmarrësit në zgjedhjen ose projektimin e ZBN-ve që janë të përshtatshme dhe superiore ndaj metodave të tjera konvencionale për PNK/DRM. Metodatat e vlerësimit ekonomik në përgjithësi synojnë të mbështesin vendimmarrësit për të zgjedhur opsionin 'më të mirë' nga një grup i bazuar në një kriter të caktuar dhe krahasuar me një skenar biznesi si zakonisht. Shembuj të zakonshëm të kriterëve të tilla janë maksimizimi i raportit kosto-përfitim, ose minimizimi i kostove që i nënshtrohen përmbushjes së një objekti të caktuar të politikës. Vendimmarrësit zgjedhin një metodë të caktuar të vlerësimit ekonomik bazuar në kriteret që ata i konsiderojnë të përshtatshme për vendimin dhe situatën e caktuar.

Masat ZBN ofrojnë përfitime të shumta të përbashkëta dhe në përgjithësi kërkojnë kosto më të ulët për t'u zbatuar në krahasim me shumë masa konvencionale për të adresuar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike ose reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Prandaj, zbatimi sistematik i metodave të vlerësimit ekonomik nuk është vetëm praktikë e mirë për vendimmarrjen dhe politikë-bërjen në përgjithësi, por gjithashtu ofron një kuadër logjik të bazuar mirë për zgjedhjen e zgjidhjeve ZBN ose hibride për të adresuar PNK dhe RRF.

Metodat e vlerësimit ekonomik duhet të integrohen në politikë-bërje, sepse ato ofrojnë një bazë të shëndoshë për projektimin dhe zbatimin e ZBN-ve. Më tej, vlerësimi i ZBN-ve përmes metodave të tilla të vlerësimit ekonomik përputhet plotësisht me Standardin Global të IUCN-së për Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (Kriteri 4: Realizueshmëria ekonomike) dhe ofron një bazë të fortë për mobilizimin e financave për ZBN-të.

Mesazhi kyç: Vlerësimi ekonomik i ZBN-ve për PNK/RRF përfshin një sërë metodash të ndryshme dhe zgjedhja e metodave të përshtatshme është një detyrë thelbësore

Një numër qasjesh janë të rëndësishme në vlerësimin ekonomik të ZBN-ve për PNK/DRM duke përfshirë analizën e kosto-përfitimit (AKP), analizën e efektivitetit të koston (AEK), analizën me shumë kriterë, si dhe qasje që marrin në konsideratë në mënyrë të qartë vlerën e elasticitetit në kushte pasigurie, të tilla si, vendimmarrja e fortë ose analiza e opsioneve reale. Përzgjedhja se cila metodë e vlerësimit ekonomik është e përshtatshme për një vendim të posaçëm të PNK-së varet nga disa faktorë. Këta faktorë përgjithësisht përfshijnë harkun kohor të opsioneve të shqyrtuara, vështirësitë e rrezikut të vendimmarrësve dhe njohurinë ose pasigurinë në lidhje me klimën e ardhshme dhe rezultatet e masave të përshtatjes (Hinkel dhe Bisaro, 2016). Për më tepër, çështjet pragmatike si disponueshmëria e të dhënave dhe burimeve mund të kufizojnë gjithashtu zgjedhjen e metodave.

Për vlerësimin ekonomik të ZBN-ve dhe PNK/DRM në veçanti, duhet të merren parasysh disa karakteristika. Së pari, është e rëndësishme të theksohet se masat e PNK-së mund të kenë shtrirje të gjata kohore (p.sh. pyjet ose mbrojtja bregdetare), me kosto dhe përfitime të larta fillestare që grumbullohen gjatë dekadave. Kjo ka ndërlkime për vendimmarrjen sepse elasticiteti ose bllokimi i një mase të caktuar duhet të merret parasysh nga metoda e vlerësimit ekonomik. Së dyti, ZBN-të kanë përfitime të shumëfishta të përbashkëta, dhe për shumë prej tyre mund të jetë e vështirë të lidhen drejtpërdrejt me një vlerë monetare. Prandaj, vlerësimi i përfitimeve të përbashkëta është veçanërisht i rëndësishëm për vlerësimin ekonomik të ZBN-ve dhe duhet të

integrohet në procesin e vlerësimit ekonomik të masave ZBN që adresojnë PNK/DRM.

Për të gjitha këto qasje, një aspekt kyç i analizës ekonomike është krijimi i një pike fillimi (d.m.th. opsioni kundërfaktik ose alternativ) kundrejt të cilit mund të vlerësohet secila nga masat PNK/DRM dhe mund të përcaktohet vlera ekonomike e rezultateve. Për shembull, nëse një masë ripyllëzimi po analizohet për të përcaktuar vlerën ekonomike të reduktimit të rrezikut nga përmbytjet që ajo siguron për komunitetet në rrjedhën a poshtme, është e nevojshme të përcaktohet se cili do të ishte niveli i rrezikut nga përmbytjet sipas opsioneve alternative. Opsione të tilla alternative përfshijnë opsionin "biznes si zakonisht" në të cilin nuk ndërmerret asnjë veprim, ose opsionet gri të infrastrukturës që mund të krahasohen më pas me ZBN-në.

Qasjet për vlerësimin ekonomik të ZBN-ve për PNK dhe MRF

Analiza kosto-përfitim (AKP)

Analiza kosto-përfitim trajton çështjen se cili opsion duhet të zgjidhet nga një grup alternativash, bazuar në vlerësimin e një metrike me të cilën alternativat mund të karakterizohen për sa i përket kostove dhe përfitimeve të tyre. Kjo do të thotë, që për AKP-në është e nevojshme të kthehen në vlerë monetare të gjitha kostot dhe përfitimet e masave. AKP-ja gjithashtu mund të japë një vlerësim absolut nëse një masë 'ia vlen të realizohet' nga një këndvështrim ekonomik, sepse mund të vlerësojë nëse një masë ofron përfitime neto pozitive. AKP-ja përfshin hapat e mëposhtëm:

1. Identifikon një grup alternativash;
2. Llogarit vlerën aktuale neto (VAN) të opsioneve të ndryshme. Kjo përfshin zgjedhjen e një afati kohor, kostot dhe përfitimet, cilat kosto dhe përfitime janë marrë parasysht dhe një normë skontimi;
3. Rregulli i vendimit: zgjedhi alternativën me VAN më të lartë ose raportin e kostos së përfitimit.

Sfidat në analizën kosto-përfitim të ZBN-ve për PNK lindin në lidhje me zgjedhjen e normës së skontimit për të llogaritur vlerën aktuale neto të opsioneve të ndryshme. Normat e skontimit janë relevante sepse përfitimet dhe kostot e ZBN-së rriten me kalimin e kohës. Normat e skontimit lidhin vlerat monetare të ardhshme me ato të tashme, që përkojnë me realitetin që njerëzit në përgjithësi preferojnë konsumin aktual në krahasim me atë të ardhshëm. Megjithatë, shqetësimet për kapitalin midis brezave ndikohen gjithashtu nga normat e skontimit dhe ofrojnë një kuadër të logjikshëm për norma të ulëta skontimi (d.m.th. mos skontimi i konsumit të ardhshëm). Analizat kosto-përfitim, veçanërisht ato me afate të gjata kohore, si në rastin e ndryshimeve klimatike, mund të jenë shumë të ndjeshme ndaj normës së skontimit të zgjedhur (Shih më poshtë për më shumë detaje).

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se AKP-ja zakonisht nuk trajton çështjet e shpërndarjes që lidhen me një opsion të caktuar. Kostot dhe përfitimet që u grumbullohen aktorëve të ndryshëm përgjithësisht agregohen në mënyrë shtesë dhe çështja e fituesve dhe humbësve trajtohet veçmas. Prandaj, AKP-ja duhet të trajtohet me kujdes dhe rezultatet e saj të konsiderohen në procesin e qeverisjes gjithëpërfshirëse dhe transparente për ZBN-të (shih Përmbledhjen e Politikave të Qeverisjes).

Shembull: Analiza kosto-përfitim e opsioneve të restaurimit të peizazhit pyjor në Kraljevo, Serbi

Në Kraljevo, Serbi, projekti ADAPT ka nisur një projekt pilot mbi opsionet e restaurimit të peizazhit pyjor (RPP) për të rritur zbutjen e përmbytjeve dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Për të mbështetur projektin pilot, u krye një analizë kosto-përfitim brenda kuadrit të një procesi të Metodologjisë së Vlerësimit të Mundësive të Restaurimit (MVMR) për të identifikuar zonat territoriale të përshtatshme për restaurim dhe menaxhim të qëndrueshëm të peizazhit, dhe për t'i dhënë përparësi zonave kryesore (IUCN, 2021). Analiza e kosto-përfitimit (AKP) mori në konsideratë ndërhyrjet RPP për përmirësimin e klimës dhe qëndrueshmërinë ekonomike

që cilësohen si ZBN, bazuar në të dhënat vendore mbi jetesën, qeverisjen dhe të ardhurat publike.

Një komponent kyç i kësaj AKP-je ishte përcaktimi i skenarit të pikës së referimit ('biznes-si-zakonisht' (BSZ)) bazuar në të dhënat biofizike dhe socio-ekonomike vendore dhe rajonale gjatë shtrirjes kohore përkatëse për krahasimin me ndërhyrje të ndryshme RPP në shqyrtim. Është zhvilluar një pikë referimi për zonën pilot të zonës Gledic, e përbërë nga një numër vendbanimesh: Gledic, Godacica, Drlupa, Petropolje, Leshevo, Ravanica, Sitnica, Milakovac dhe Zakuta. Të dhënat socio-ekonomike, p.sh., për sektorët demografikë, punësimin dhe ekonominë u mblodhën nga autoritetet kombëtare dhe vendore, ndërsa të dhënat për jetesën, shpenzimet familjare etj., u mblodhën brenda vendbanimeve. Më tej, të dhënat biofizike mbi, p.sh. atributet e peizazhit u zhvilluan nga analiza GIS. Këto të dhëna janë përdorur për të vlerësuar kostot financiare dhe përfitimet e prodhuara nga masat. Kostot dhe përfitimet u zgjodhën bazuar në elementët që janë të rëndësishëm për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë (RRF) dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (PNK) dhe zhvillimin ekonomik të zonës pilot.

Kostot financiare dhe përfitimet e lidhura me skenarin e pikës së referimit të biznesit si zakonisht janë paraqitur në tabelën 1. Treguesit janë grupuar në kosto private, kosto publike direkte dhe kosto publike indirekte nga fatkeqësitë dhe erozioni. Kostot dhe përfitimet publike direkte janë të përmasave të ngjashme, megjithatë kur merren parasysh kostot indirekte të fatkeqësive, kostot publike bëhen shumë më të rëndësishme në skenarin BSZ. Kjo nënkupton që aktorët publikë mund të jenë të gatshëm të financojnë ZBN-të që reduktojnë këto kosto. Si hap tjetër në analizën e skenarit BSZ, u krye një zbritje e kostove dhe përfitimeve të ardhshme gjatë një periudhe kohore 20-vjeçare për të llogaritur vlerën aktuale neto (VAN) (për detaje shih (IUCN, 2021).

Më pas, AKP-ja vlerësoi tre opsione të ndryshme ZBN duke përdorur të njëjtën qasje në mënyrë që t'i krahasojë këto me BSZ dhe të zgjidhë opsionin më të mirë. Secila ZBN kombinoi ndërhyrje të ndryshme RPP nëpër vende të ndryshme dhe mund të karakterizohet si më poshtë:

- ZBN1: Masat bio-inxhinierike, Kultivimi i bimëve mjekësore dhe aromatike dhe sistemet Silvo-baritore;

- ZBN2: Rehabilitimi i pyjeve natyrore, rehabilitimi me mbjellje dhe mbjellja për pasurim të tokës;
- ZBN3: Masat bio-inxhinierike, Kultivimi i sistemeve mjekësore dhe aromatike, Silvo-baritore, Rehabilitimi Natyror i Pyjeve, Rehabilitimi me mbjellje dhe mbjellja për pasurim të tokës.

Tabela 1. Treguesit financiarë për kostot dhe përfitimet në skenarin bazë për analizën e AKP-së në Kraljevo, Serbi. (burimi: IUCN, 2021).

Item	Njësia	Çmimi për Njësi EUR	Sasia	Gjithsej EUR	Intervali Kohor	Gjithsej në Vit EUR
Kostot Private						14.958.365,02
Taksa mbi Pronën	Familje	8,84	14908	131.750,00	i përvitshëm	131.750,00
Ujësjellësi	Familje	130,73	901	117.787,73	Muaj	1.413.452,76
Mirëmbajtja e Zonave Pyjore	EUR/ha	1.486,52	6701,03	9.961.231,87	i përvitshëm	9.961.231,87
Kostot Publike						486.501,72
Kostot për Mbrojtjen Civile	EUR	0,61	14908	9.073,62	i përvitshëm	9.073,62
Organizata Turistike	EUR	1,45	14908	21.522,91	i përvitshëm	21.522,91
Management Costs						455.905,18
Stafi SG "Stolovi"	Pagë	741,57	36	26.696,66	Muaj	320.359,97
Stafi LSG Kraljevo	Pagë	706,82	3	2.120,45	Muaj	25.445,43
Mirëmbajtja e Zonave Pyjore	EUR/ha	48,81	2256	110.099,79	i përvitshëm	110.099,79
Kostot për Fatkeqësitë Natyrore						1.364.356,11
Dëmi nga Fatkeqësitë Natyrore						1.364.356,11
Infrastruktura për Kategori	Njësi	e paaplikueshme	e paaplikueshme	1.364.356,11	i përvitshëm	1.364.356,11
Erozioni						9.553,79
Degradimi i Tokës	M3/ha	e paaplikueshme	e paaplikueshme	9.553,79	Vit	9.553,79
Sekuestrimi i CO2						10.139.763,99
Sekuestrimi i Karbonit	T/Ha	5,92	1714498	10.139.755,49	Vit	10.139.763,99
Përfitimet Private						6.004.817,72
Të Ardhurat Vetjake						5.909.379,72
Të Ardhurat Vetjake nga Bujqësia	Pagë	585,00	289	169.065,42	Muaj	2.028.785,03
Të Ardhurat Vetjake nga Pyjet	Pagë	580,29	432	250.683,77	Muaj	3.008.205,22
Të Ardhurat Vetjake nga Turizmi	Pagë	390,86	186	72.699,12	Muaj	872.389,48
Subvencionet	EUR/ha	34,00	2807	95.438,00	i përvitshëm	95.438,00
Përfitimet Publike						655.488,15
Dhënia e Tokës me Qira	EUR	na		918,00	i përvitshëm	918,00
Tarifat për Tokën Bujqësore	EUR	na		6.885,00	i përvitshëm	6.885,00
Turizmi	Numri i tarifave	na		10.166,09	i përvitshëm	10.166,09
Taksa mbi Pronën	EUR	na		412.250,00	i përvitshëm	412.250,00
Lënda Drusore	EUR	na		225.269,07	i përvitshëm	225.269,07

Të tre këto opsione u vlerësuan më pas bazuar në të njëjtët tregues financiarë të paraqitur në tabelën 1 dhe iu nënshtruan të njëjtës procedurë skontimi në një hark kohor 20-vjeçar për të arritur në një VAN për secilën masë.

Figura 1 tregon VAN-në që rezultojnë e llogaritur për çdo ZBN. Të tre opsionet ZBN kanë VAN-në më të lartë në krahasim me pikën e referimit me ZBN3 që tregon VAN-në më të lartë. Vlen të përmendet se ZBN2, ndërkohë që një përmirësim mbi pikën e referimit në të vërtetë ka një VAN negative, megjithëse është akoma më tërheqëse se alternativa BSZ. Një paralajmërim tjetër është se kostot e llogaritura gjithashtu varen fuqishëm nga kostot e parashikuara të fatkeqësive, të cilat për nga natyra e ngjarjeve ekstreme shoqërohen edhe nga pasiguria. Studimi i AKP-së parashikoi gjithashtu kostot e fatkeqësive përmes një kuadri modelimi që llogarit këtë pasiguri dhe rezultatet e paraqitura në Figurën 1 përfaqësojnë vlerat mesatare të kësaj analize. Kontabilizimi i kësaj pasigurie e bën ZBN3 edhe më tërheqës sepse mospërputhja e kostove të fatkeqësive ishte më e vogël për ZBN3 për shkak të këtij opsioni që përbëhet nga masa që adresojnë drejtpërdrejt rreziqet e përmbytjeve (për detaje shih (IUCN, 2021)).




Figura 1. Vlera aktuale neto (VAN) e llogaritur për skenarin e pikës së referimit dhe 3 opsione ZBN në Kraljevo, Serbi.

Analiza e efektivitetit të kostos (AEK) e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe opsioneve MRF

Analiza e efektivitetit të kostos trajton gjithashtu çështjen se cilat opsione duhet të zgjidhen nga një grup alternativash. Ai ndryshon nga AKP-ja në atë që AEK-ja bazohet në dy metrika të ndryshme: një metrikë për kostot e masave dhe një metrikë të ndryshme për ndikim. AEK-ja përfshin hapat e mëposhtëm:

1. zgjidhni një metrikë për efektivitetin E (p.sh. ndikimet në popullatë, biodiversitet, etj.)
2. zgjidhni një bazë kundrejt së cilës do të maten efektet
3. zgjidhni një grup alternativash që mund të aplikohen për të arritur objektivin
4. për çdo alternativë I, llogaritni raportin e efektivitetit të kostos (CER): $CER_i = E_i/C_i$
5. Rregulli i vendimit: zgjidhni alternativën i^* me CER^* më të lartë

Analiza e efektivitetit të kostos është vetëm një masë relative e një grupi opsionesh në lidhje me një rezultat të përcaktuar. AEK-ja është e përshtatshme pasi të dakordësohen objektivat e veçanta të politikave dhe kërkohet një vendim në lidhje me masat që mund ta arrijnë më mirë këtë.

Është e rëndësishme të theksohet se AEK-ja është e përshtatshme kur ekziston një metrikë e vetme e efektivitetit për rezultatet. Për ZBN-të për PNK/RRF, është për rrjedhojë një qasje e kufizuar për të krahasuar alternativat që kanë ndikime në rreziqe të shumta të ndryshme sepse shpesh nuk mund të gjendet asnjë metrikë e përbashkët e PNK-së për të gjithë rreziqet. Për shembull, matjet e përfitimeve të PNK-së ndryshojnë në varësi të faktit nëse sukcesi i përshtatjes vlerësohet në lidhje me numrin e pronave të dëmtuara nga përmbytjet, rritjen e vdekshmërisë gjatë valëve të të nxehtit, uljen e rendimenteve bujqësore, etj. Megjithatë, për ZBN-të që adresojnë rreziqe të veçanta të lidhura me klimën, mund të jetë më e lehtë të gjendet metrika e duhur e rezultateve për efektivitetin. Për shembull, masat AEK të ZBN-ve për reduktimin e rrezikut të përmbytjeve të lumenjve, për shembull, përmes restaurimit të pyjeve bregore janë të mundshme.

Shembull: Analiza e kosto-efektivitetit të biodiversitetit të kullotave në Finlandë

Në Finlandë, biodiversiteti i kullotave është i kërcënuar pasi habitatet do të zhvendosen për shkak të ndryshimeve klimatike dhe korridoret e shpërndarjes së specieve rrezikojnë të mbyllën nga intensifikimi i bujqësisë. Biodiversiteti i kullotave në Finlandë kontribuon në cilësinë e peizazhit dhe në këtë mënyrë sjell përfitime të përbashkëta socio-ekonomike për komunitetet vendore. Një analizë e fundit ekonomike e opsioneve të ndryshme për të ruajtur speciet kryesore të fluturave nën trysinë e ndryshimeve klimatike kryen një analizë kosto-efektiviteti brenda skenarëve të ndryshëm klimatikë për të zgjedhur opsionin më të mirë (më kosto-efektiv) për ruajtjen e llojeve kryesore të fluturave sipas të gjithë skenarëve klimatikë të ardhshëm (Tainio et al., 2014). Opsionet e përshtatjes përfshijnë ZBN-të që përfshijnë mirëmbajtjen e korridoreve shpërndarëse dhe zhvendosjen e llojeve të kullotave. Vlerësimi zbatoi një qasje të modelimit të mjedisit bioklimatik për të projektuar ndryshimin e habitatit të specieve të fluturave përfaqësuese sipas 11 skenarëve të ndryshimeve klimatike në të ardhmen me një rezolucion territorial prej 2 km kuti në rrjetin e koordinatave. Qasja gjithashtu kreu sondazhe për të nxjerrë informacionin e koston mbi opsionet e përshtatjes dhe vlerësoi kosto-efektivitetin e tyre në ndryshimin e ardhshëm klimatik. Për shkak të variacionit të lartë në habitatet e përshtatshme nga ana klimatike në modelet dhe skenarët e ndryshëm, një vlerësim i ndikimeve për secilën zonë në të gjithë skenarët dhe kombinimet e modeleve ishte i nevojshëm për një krahasim gjithëpërfshirës për të identifikuar opsionin më kosto-efektiv në të gjithë skenarët. Ata zbuluan se zhvendosja e specieve ishte opsioni më me kosto efektive brenda secilit skenar.

Mesazhi kyç: Metodatat e vlerësimit ekonomik janë mjete veçanërisht të rëndësishme për të ofruar një pamje të plotë të përfitimeve nga ZBN-të

Një tipar dallues i analizës ekonomike të ZBN-ve në krahasim me analizën standarde ekonomike të masave PNK/DRM është se ZBN-të prirën të prodhojnë përfitime të shumta të përbashkëta financiare, sociale dhe mjedisore të mbështetura nga shërbimet e ekosistemit që ato ofrojnë. Vlerësimi ekonomik i këtyre përfitimeve të përbashkëta mbështet një analizë ekonomike gjithëpërfshirëse dhe informuese të ZBN-ve. Vlera ekonomike e përfitimeve të përbashkëta të prodhuara nga ZBN-të varet nga natyra e shërbimit, sistemi që e ofron atë dhe atributet e komuniteteve që përfitojnë prej tyre. Tabela 2 paraqet përfitimet e përbashkëta për lloje të ndryshme të sistemeve natyrore (UNEP, 2020).

Tabela 2. Përfitimet e përbashkëta të ZBN-ve për lloje të ndryshme të sistemeve natyrore (UNEP 2020).

Sistemi	Zgjidhje e bazuar në natyrë	Përfitimi shoqëror
Pyjor	Ruajtja	Zbutja e gazeve me efekt serrë (GHG) nëpërmjet sekuestrimit të karbonit në biomasë në bimësi dhe tokë; mbrojtja e biodiversitetit; mbrojtja nga përmbytjet, thatësira dhe erozioni, rekreacioni dhe turizmi, filtrimi dhe ruajtja e ujit
	Restaurimi	
	Menaxhimi i përmirësuar i prerjes së drurëve të zjarrit	Zbutja e gazeve me efekt serrë (GHG) nëpërmjet sekuestrimit të karbonit në biomasë në bimësi dhe tokë; sigurimi i drurëve të zjarrit dhe produkteve pyjore për mbrojtjen e komuniteteve vendore nga përmbytjet, thatësira dhe erozioni
	Prodhimi	Sekuestrimi i karbonit në biomasën e sipërfaqeve të mbjella dhe produkteve të korrura; të ardhura të qëndrueshme; filtrimi dhe ruajtja e ujit; ulja e trysnisë mbi pyjet natyrore
Kullosor	Ruajtja	Sekuestrimi i karbonit në biomasën e bimësisë dhe tokës; mbrojtja e biodiversitetit; stabilizimi i pjerrësisë
	Restaurimi	
	Menaxhimi i kullotjes	Sekuestrimi i karbonit në biomasën e bimësisë dhe tokës; stabilizimi i pjerrësisë
Bregdetar/bregor	Ruajtja	Mbrojtja e jetës dhe e pronës nga stuhitë dhe përmbytjet; sekuestrimi i karbonit; rritja e biodiversitetit dhe prodhimit të peshkimit
	Restaurimi	
	Mirëmbajtja e bimësisë së shpatit	Erozioni i reduktuar dhe stabilizimi i pjerrësisë
	Mirëmbajtja e bimësisë në zonat bregdetare, të zonave të përmbytjes dhe atyre lumore	Mbrojtja e jetës dhe e pronës nga stuhitë dhe përmbytjet; sekuestrimi i karbonit
Bujqësor	Agropylltaria	Sekuestrimi i karbonit në tokë dhe biomasë; erozion i reduktuar; ruajtja e pjellorisë së tokës; habitati i pjalmuesit; mbrojtje nga stuhitë; sigurimi i hijes
	Reduktim i praktikave të lërimit të tokës dhe restaurimit të karbonit	Sekuestrimi i karbonit në tokë; ruajtja e pjellorisë së tokës
	Intensifikimi i bujqësisë	Siguria e shtuar e ushqimit; ulja e trysnisë për shndërrimin e sipërfaqeve të tjera.

Urban	Pyjet urbane dhe hapësirat e gjelbra	Sekuestrimi i karbonit në biomasë në bimësi; sigurimi i hijes; largimi i ujërave të stuhisë dhe mbrojtja nga përmbytjet; rekreacion
	Çatitë e gjelbra	Ftohje; kontrolli i ujërave të stuhisë; ulja e ndotjes; sekuestrimi i karbonit

Për t'i bashkëngjitur një vlerë ekonomike secilës prej këtyre përfitimeve të përbashkëta të ndryshme shoqërore, mund të zbatohen një sërë metodash vlerësimi në varësi të llojit të posaçëm të përfitimit të përbashkët në fjalë. Për shembull, për ndryshimet në vlerat e pasurive të paluajshme për shkak të afërsisë me hapësirën e gjelbër, metodat hedonike të çmimeve janë një metodë e përcaktuar vlerësimi (Bin et al., 2011). Në të kundërt, për ndryshimet në vlerën e komoditetit mjedisor për shkak të peizazheve natyrore të përmirësuar, metodat e vlerës së kushtëzuar siç janë metodat e gatishmërisë për të paguar janë një metodë e përcaktuar vlerësimi (Trombi et al., 2011). Shihni gjithashtu (Díaz et al., 2015; IBPES, 2022).

Pasi të jenë aplikuar metodat e vlerësimit për përfitimet e përbashkëta nga ZBN-të, metodat e analizës së vendimeve ekonomike mund të zbatohen për të zgjedhur një ose më shumë ZBN që adresojnë PNK/RRF nga një grup alternativash. Siç u diskutua më lart, secila metodë është e përshtatshme për t'u zbatuar në varësi të një sërë faktorësh, duke përfshirë harqet kohore dhe kostot e masave që merren në konsideratë, si dhe nga aspektet praktike, të tilla si koha, burimet dhe aftësitë e disponueshme për vlerësimin ekonomik.

Mesazhi kyç: Metodat e normës së skontimit janë gjithashtu thelbësore sepse shumë ZBN ofrojnë përfitime që grumbullohen gjatë periudhave më të gjata kohore

Në çdo metodë të vlerësimit ekonomik për ZBN-të për PNK/RRF, normat e skontimit janë një hap i rëndësishëm metodologjik për

të arritur në analizën gjithëpërfshirëse të kostove dhe përfitimeve të një opsioni të caktuar. Kjo ndodh për shkak se koha e përfitimeve dhe kostove ekonomike mund të shpërndahet në harkun kohor të një mase që mund të variojë nga disa muaj ose vite deri në disa dekada ose më shumë. Një rishikim i kohëve të fundit i ZBN-ve që adresojnë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në nivel global zbuloi se përfitimet mund të rriten në një periudhë të afërt kohore, p.sh. nga rritjet e menjëhershme të të ardhurave nga bujqësia ose peshkimi, ndërsa në raste të tjera përfitimet mund të mos sigurohen edhe për një periudhë 20 vjeçare pas zbatimit të masës (Reid et al., 2019) . Ky i fundit mund të jetë rasti për masat afatgjata, si ripyllëzimi, në të cilin duhet kohë që pemët të rriten dhe për rrjedhojë të rriten përfitimet nga ZBN-të. Në të vërtetë, nga rishikimi i projekteve ZBN u zbuluan arsyet e mëposhtme për vonesat në përlogaritjen e përfitimeve:

- Grumbullimi i ujit në digat me rërë,
- Rimëkëmbja e burimeve natyrore të shfrytëzuara pa kriter dhe të degraduara rëndë,
- Rritja e pemëve,
- Institucionet e reja, regjimet e menaxhimit, praktikat e kullotjes apo bujqësisë bëhen efektive,
- Restaurimi i zonave kullimore,
- Krijimi i suksesshëm i bizneseve të reja, dhe
- Projektet e ekoturizmit: të cilave mund të duhen disa vite për të zhvilluar marketingun dhe kërkesën.

Shembull: Analiza kosto-përfitim e ZBN për menaxhimin e kullotave në Canchayllo, Peru

Në ekosistemet malore të Perusë, një numër ZBN që adresojnë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike u prezantuan në komunitetet Canchayllo dhe Miraflores. Një AKP analizo raportet e kostos së përfitimit për biznesin si zakonisht në zonat e kontrollit në të dy komunitetet dhe i krahasoi ato me zonat e projektit ZBN në të njëjtat komunitete për një periudhë afatgjatë. Analiza zbuloi se prezantimi i Përsh-

tatjes së Bazuar në Ekosistemin (PBE), një qasje ZBN, ishte e dobishme nga ana financiare kur krahasohej me biznesin si zakonisht, por vetëm në periudhë afatgjatë për normën e papërfillshme të skontimit prej 4%. Në të vërtetë, kostot e ndërhyrjeve ZBN u neutralizuan pas 10-15 vjetësh (Reid et al. 2019). Më tej, kur një grup më i gjerë përfitimesh dhe kostosh u përfshi në analizë përmes të dhënave të mbledhura nga anketimet, niveli i tërheqjes së ndërhyrjeve ZBN u rrit më tej duke e çuar raportin përfitim-kosto në 2.2 (shih Figurën 1). Gjetjet mbi përfitimet në rritje sugjerojnë se gatishmëria e komuniteteve vendore për të përballuar disa kosto afatshkurtra të kalimit në masat ZBN mund të jetë pjesërisht për shkak të përfitimeve të pritshme afatgjata që nuk shprehen lehtësisht në vlera monetare dhe se këto përfitime perceptohen mirë nga komunitetet vendore.




Figura 1. Raporti përfitim-kosto kundrejt biznesit si zakonisht për menaxhimin e kullotave vendase në Canchayllo, Peru. Norma e përdorur e skontimit 4%. (Reid et al. 2019).

Figura 1 tregon se projekti grumbullon përfitime për periudha të gjata, duke bërë që raporti kosto-përfitim të jetë pozitiv në periudhë afatgjatë. Meqenëse normat e skontimit mund të zvogëlojnë ndjeshëm vlerën aktuale të flukseve financiare të ardhshme, analizat e zbatuara kosto-përfitim me norma të larta të skontimit mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë ekonomike të një ZBN-je, veçanërisht në zonat që janë degraduar rëndë dhe për këtë arsye kërkojnë investime afatgjata (Reid et al. 2019). Çështja e afateve kohore në analizën ekonomike thekson rëndësinë e vlerësimit të të gjitha përfitimeve të përbashkëta të ZBN-ve në mënyrë që të merret një pamje e plotë e masës ZBN krahasuar me masat konvencionale ose të status quo. Ky argument përforcohet nga Figura 1, e cila tregon vetëm një raport shumë të lartë pozitiv përfitim-kosto për masën e ndërmarrë, kur përfitimet e përbashkëta më të gjera konsiderohen përtej asaj që mund të matet drejtpërdrejt (Reid et al. 2019).

Referencat

- Bin, O., Poulter, B., Dumas, C.F., Whitehead, J.C., 2011. Measuring the impact of sea-level rise on coastal real estate: A hedonic property model approach. *Journal of Regional Science* 51, 751–767.
- Díaz, S., Demissew, S., Carabias, J., Joly, C., Lonsdale, M., Ash, N., Larigauderie, A., Adhikari, J.R., Arico, S., Báldi, A., 2015. The IPBES Conceptual Framework—connecting nature and people. *Current opinion in environmental sustainability* 14, 1–16.
- Hinkel, J., Bisaro, A., 2016. Methodological choices in solution-oriented adaptation research: a diagnostic framework. *Reg Environ Change* 16, 7–20. <https://doi.org/10.1007/s10113-014-0682-0>
- IPBES, 2022. Economic valuation methods for biodiversity. IPBES.
- IUCN, 2021. Forest Landscape Restoration Opportunities Assessment, Municipality of Kraljevo, Serbia. IUCN ECARO.
- Reid, H., Hou Jones, X., Porras, I., Hicks, C., Wicander, S., Seddon, N., Kapos, V., Rivzi, A.R., Roe, D., 2019. Is ecosystem-based adaptation effective? Perceptions and lessons learned from 13 project sites (IIED Research Report). IIED.
- Seddon, N., Sengupta, S., García-Espinosa, M., Hauler, I., Herr, D., Rizvi, A.R., 2019. Nature-based Solutions in Nationally Determined Contributions. IUCN and University of Oxford.
- Stern, N., 2006. Stern Review on the Economics of Climate Change. HM Treasury, UK.
- Tainio, A., Heikkinen, R.K., Heliölä, J., Hunt, A., Watkiss, P., Fronzek, S., Leikola, N., Lötjönen, S., Mashkina, O., Carter, T.R., 2014. Conservation of grassland butterflies in Finland under a changing climate. *Reg Environ Change* 1–14. <https://doi.org/10.1007/s10113-014-0684-y>
- Trombi, G., Moriondo, M., Bindi, M., Fagarazzi, C., Ferrise, R., Cai, M., 2011. The impacts of the climate change on Tuscan viticulture: qualities, areas and landscapes, in: First European Conference on Wine and Food Tourism Volterra (Pisa) Italy, April 13-15 2011. Maria Francesca Romano Edizioni.
- UNEP, 2020. Economics of Nature-based Solutions: Current Status and Future Priorities. United Nations Environment Programme Nairobi.

Burime të mëtejshme

- Restoration Opportunities Assessment Methodology (ROAM): <https://www.wri.org/research/restoration-opportunities-assessment-methodology-roam>
- United Nations Environmental Assessment (UNEA) resolution on Nature-based Solutions: <https://wedocs.unep.org/bitstream/handle/20.500.11822/39864/NATURE-BASED%20SOLUTIONS%20FOR%20SUPPORTING%20SUSTAINABLE%20DEVELOPMENT.%20English.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

Përmbledhja e politikave: Financimi i Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë

**ADAPT: Zgjidhje të Bazuara në Natyrë për shoqëritë me aftësi
ripërtëritëse në Ballkanin Perëndimor**




IUCN ECARO

Autor:
Alexander Bisaro



Recensentë:
Mihaela Dragan-Lebovics, Kristin Meyer, Leander Raes

Mesazhet kyçe për financimin e ZBN-ve.....	24
Hyrje	26
Mesazhi kyç: kufizimet financiare për PNK dhe RRF mund të kapërcehen duke investuar në zgjidhje të bazuara në natyrë për të shfrytëzuar burimet publike nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm	28
Mesazhi kyç: zgjidhjet e bazuara në natyrë mund të mobilizojnë investimet private për shkak të përfitimeve të përbashkëta që prodhojnë, duke reduktuar kështu nevojat për investime publike totale në PNK/RRF.....	30
Kutia 1. Mobilizimi i investimeve të jashtme në Parkun natyror Lonjsko polje, Kroaci	31
Mesazhi kyç: zgjidhjet e bazuara në natyrë mund të tërheqin financa të jashtme ndërkombëtare për klimën dhe zhvillimin me një mandat për të shmangur rrezikun e investimeve private për projektet e natyrës dhe klimës.	33
Mesazhi kyç: zgjidhjet e bazuara në natyrë mund të nxisin investimet publike duke prodhuar përfitime të përbashkëta, të tilla si përmirësimi i cilësisë mjedisore, që gjenerojnë të ardhura tatimore nga aktivitetet e shtuara rekreative.	35
Kutia 2. Gjenerimi i të ardhurave tatimore nga përfitimet e përbashkëta të zbn-ve në restaurimin e peizazhit pyjor në Kraljevo, Serbi	36
Mesazhi kyç: promovoni dhe integroni burime të dedikuara financimi për ZBN-të në politika dhe planifikim, pasi financimi i ZBN-ve mbetet një mangësi e rëndësishme.....	38
Kutia 3. Gjenerimi i të ardhurave nëpërmjet tarifave mbi ujërat e stuhisë për menaxhimin e gjelbër të përmbytjeve urbane në Kopenhagë	39
Referencat	42
Burime të mëtejshme	42

Mesazhet kyçe për financimin e ZBN-ve

-  **Kufizimet financiare për investimet publike në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (PNK) dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë (RRF) mund të kapërcehen duke investuar në Zgjidhje të Bazuara në Natyrë që adresojnë PNK/RRF dhe shfrytëzojnë burimet publike përmes mekanizmave të ndryshëm.** Mekanizmat premtues për nxitjen e investimeve publike përfshijnë mobilizimin e investimeve të jashtme (përfshirë ato nga sektori privat), gjenerimin e të ardhurave nga tregu ose rritjen e të ardhurave nga taksat përmes projekteve që prodhojnë përfitime të përbashkëta, të tilla si përmirësimi i cilësisë mjedisore që i bën zonat më tërheqëse për turizmin ose mbështesin peshkimin, bujqësinë apo pylltarinë e qëndrueshme.
-  **Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë mund të mobilizojnë investime private shtesë, sepse përfitimet përbashkëta të cilësisë së përmirësuar të mjedisit mund të krijojnë kushtet për modele të suksesshme biznesi, të tilla si eko-turizmi, pylltaria e qëndrueshme, peshkimi dhe akuakultura e qëndrueshme, bletaria ose bujqësia e qëndrueshme.** ZBN-të duhet të projektohen në mënyrë që të shtohen mundësitë për mobilizimin e investimeve shtesë të sektorit privat, duke krijuar kushte që lejojnë lulëzimin e bizneseve të gjelbra. Kjo përfshin rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndërtimin e kapaciteteve dhe drejtimit në lidhje me mundësitë e sipërmarrjes së gjelbër.
-  **Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë mund të tërheqin financa të jashtme ndërkombëtare për klimën dhe zhvillimin me një mandat për të shmangur rrezikun e investimeve private për projektet e natyrës dhe klimës.** Mundësitë e kombinuara financuese për ZBN-të në përgjithësi duhet të synojnë

fondacionet ose investuesit e tjerë me ndikim pasi investuesit tregtarë janë më pak të spikatur. Një përjashtim të dukshëm përbëjnë modelet e biznesit për ZBN-të që përfshijnë zonat e ruajtjes të përdorura për kompensimin e karbonit. Tërheqja e financave të përziera si përmes institucioneve financiare ndërkombëtare, ashtu edhe investuesve ose fondacioneve private mund të lehtësohet duke projektuar ZBN në përputhje me Standardin Global të IUCN-së për Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë™.

-  **Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë mund të nxisin investimet publike duke prodhuar përfitime të përbashkëta, të tilla si përmirësimi i cilësisë së mjedisit, që mund të gjenerojë të ardhura tatimore nga rritja e aktiviteteve rekreative.** Zgjidhjet e bazuara në natyrë ofrojnë mundësi të rëndësishme për aktorët publikë për të gjeneruar të ardhura tatimore shtesë dhe për të rikuperuar investimet në masat e përshtatjes dhe të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë, sepse zgjidhje të tilla të bazuara në natyrë prodhojnë përfitime të përbashkëta të cilësisë së përmirësuar mjedisore. Ky përmirësim mund ta bëjë një zonë më tërheqëse për rekreacion dhe turizëm duke ofruar kështu mundësi për rritjen e të ardhurave tatimore të krijuara nga këto aktivitete.
-  **Promovoni dhe integroni burime të dedikuara financimi për ZBN-të në politika dhe planifikim, pasi financimi i ZBN-ve mbetet një mangësi e rëndësishme.** Rishikimet e fundit të politikave në Ballkanin Perëndimor tregojnë se megjithëse ZBN-të mund të artikulojnë në politika dhe plane, rrallë janë në zbatim marrëveshje të hollësishme financiare ose burime financimi për të siguruar zbatimin e tyre. Një sërë instrumentesh novatore financimi duhet të përdoren për ZBN-të, duke përfshirë Pagesat për Shërbimet e Ekosistemit (PSHE) dhe partneritetet publiko-private. Më tej, zhvillimi mbi instrumentet ekzistuese tatimore ose marrëveshjet e tarifave të përdoruesve përmes tarifave shtesë ose tarifave mjedisore është gjithashtu një qasje premtuese. Të gjitha këto qasje kërkojnë mobilizimin e buxheteve të dedikuara për ZBN-të, dhe për rrjedhojë një koordinim të ngushtë me Ministrinë e Financave.

Hyrje

Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZBN) po fitojnë rëndësi në mbarë botën si masa me kosto të mundshme efektive që ofrojnë njëkohësisht përfitime mjedisore, sociale dhe ekonomike dhe ndihmojnë në ndërtimin e aftësisë ripërtëritëse. Në të vërtetë, gjatë Asamblesë së Mjedisit të Kombeve të Bashkuara, mbajtur në Nairobi në vitin 2022, liderët botërorë miratuan një rezolutë mbi Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë për Mbështetjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Rezoluta u bën thirrje shteteve anëtare të mbështesin zbatimin e ZBN-ve në partneritetet me komunitetet vendore, gratë, të rinjtë dhe popujt indigjenë dhe aplikimin e një qasjeje të drejtuar nga vendi, të përgjigjshme gjinore, pjesëmarrëse dhe plotësisht transparente.

ZBN-të ofrojnë potencial për të sjellë karakteristika dhe procese të ndryshme natyrore në qytete, peizazhe tokësore dhe detare, dhe adresojnë një sërë sfidash shoqërore, duke përfshirë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë (Seddon et al., 2020). Në të njëjtën kohë, qeveritë në mbarë botën, përfshirë Ballkanin Perëndimor, përballen me sfida të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë në bazë të buxheteve të kufizuara dhe kapaciteteve të kufizuara financiare. Në këtë kontekst, ZBN-të mund të jetë veçanërisht tërheqëse për adresimin e PNK/MRF jo vetëm për shkak të kostonë së tyre relativisht të ulët, por edhe për shkak të potencialit të tyre për të nxitur investimet publike duke tërhequr ose mobilizuar financime të jashtme shtesë (p.sh. financat e zhvillimit) ose duke gjeneruar të ardhura.

Kjo Përmbledhje e Politikave eksploron rolin e ZBN-ve në shfrytëzimin e investimeve publike dhe mobilizimin e financave për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe masat për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Në veçanti, përmbledhja përshkruan mekanizma të ndryshëm për shfrytëzimin e financave dhe i ilustron këto përmes rasteve studimore.

Përkufizimet kyçe

Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZBN) janë veprime për të mbrojtur, menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe restauruar ekosistemet natyrore ose të modifikuara, që adresojnë sfidat shoqërore në mënyrë efektive dhe të përshtatur, duke siguruar njëkohësisht mirëqenien njerëzore dhe përfitimet nga biodiversiteti (IUCN, 2016).

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është procesi i përshtatjes me klimën aktuale ose të pritshme dhe pasojat prej saj. Në sistemet njerëzore, përshtatja kërkon të zbusë ose shmangë dëmin, ose të shfrytëzojë mundësitë e dobishme. Në disa sisteme natyrore, ndërhyrja njerëzore mund të lehtësojë përshtatjen me klimën e pritur dhe pasojat prej saj (IPCC, 2014).

Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë ka për qëllim parandalimin e rrezikut të ri dhe reduktimin e rrezikut ekzistues të fatkeqësive (ekspozimi, rreziku ose cenueshmëria) dhe menaxhimin e rrezikut të mbetur, të gjitha këto kontribuojnë në forcimin e elasticitetit dhe rrjedhimisht në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm (IPCC, 2014; UNISDR, 2017).

Financat e përziera i referohen përdorimit strategjik të financave të zhvillimit për mobilizimin e financave shtesë drejt zhvillimit të qëndrueshëm në vendet në zhvillim (OECD, 2020).

Mesazhi kyç: Kufizimet financiare për PNK dhe RRF mund të kapërcehen duke investuar në Zgjidhje të Bazuara në Natyrë për të shfrytëzuar burimet publike përmes mekanizmave të ndryshëm

Duke pasur parasysh kufizimet buxhetore për qeveritë në mbarë botën, përfshirë Ballkanin Perëndimor, një qasje gjithnjë e më premtuese për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë po përqendrohet në projekte që mund të nxisin financat publike. Shfrytëzimi i financave publike i referohet përmbyshjes së rezultateve të larta me të njëjtën sasi të investimeve publike. Për shembull, nëse një qeveri investon në mbushjen e plazhit me rërë për mbrojtjen nga përmbytjet, dhe më pas gjeneron të ardhura nga taksat nga rritja e shpenzimeve turistike, është shfrytëzuar financimi i qeverisë për masën e mbrojtjes nga përmbytjet. ZBN-të në përgjithësi kanë një potencial të madh për të nxitur investimet publike sepse përveç adresimit të sfidave shoqërore, të tilla si përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike ose menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë, ZBN-të prodhojnë gjithashtu një sërë përfitimesh të përbashkëta. Nëpërmjet restaurimit dhe ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit, ZBN-të përmirësojnë kushtet mjedisore që çojnë në përfitime të përbashkëta, të tilla si përmirësimi i mundësive rekreative, përmirësimi i rezultateve të shëndetit dhe mirëqenies, ose ndër të tjera, rritja e ruajtjes së karbonit për zbutjen e gazit serrë.

Shfrytëzimi i investimeve publike në ZBN që adresojnë PNK/RRF mund të arrihet nga projekte që prodhojnë përfitime të tilla të përbashkëta. Këto përfitime të përbashkëta mund të përdoren për të nxitur financimin nëpërmjet tre mekanizmave të përgjithshëm (të paraqitur në tabelën 1): mobilizimi i investimeve të

jashtme në ZBN nga donatorët, filantropët ose sektori privat; gjenerimi i të ardhurave nëpërmjet transaksioneve të tregut (p.sh. shitja ose dhënia me qira e tokës); ose gjenerimi i të ardhurave nëpërmjet instrumenteve tatimore. Për dy mekanizmat e fundit, ZBN-të krijojnë burime të ardhurash shtesë duke përmirësuar mjedisin natyror dhe duke krijuar kështu vlerë që mund të përfitohet nga qeveritë që iniciojnë ZBN-të.

Tre mekanizma për nxitjen e investimeve publike përmes ZBN-ve janë paraqitur në tabelën 1. Ato janë ilustruar përmes shembujve që përfshijnë zhvillimin e pyjeve të komunitetit, të mbështetur nga bashkëfinancimet e OJQ-ve dhe sektorit filantropik, rizhvillimin e tokës së gjelbër urbane dhe mbushjen e plazhit me rërë që çon në përfitim të përbashkët ekologjik. Në përgjithësi, potenciali për shfrytëzim nëpërmjet këtyre mekanizmave është më i madh në zonat me popullsi të dendur, ose që kanë nivele të larta të vlerës dhe aktivitetit ekonomik. Në mjedis të tilla, vlerat e tokës dhe gatishmëria për të paguar për aktivitete rekreative janë të larta, të cilat janë kushte të nevojshme për të gjeneruar të ardhura nga tregu ose nga taksat.

Tabela 1. Mekanizmat, instrumentet dhe shembujt e shfrytëzimit të investimeve publike në ZBN për projektet PKN.

Mekanizmat për shfrytëzimin e financave publike nga ZBN-të	Instrument	Shembuj
Mobilizimi i investimeve të jashtme	Bashkëfinancim ose marrëveshje financimi të përziera Pagesa për Shërbimet e Ekosistemit	Parku Natyror Lonskjo Polje (Kroaci, shih Kutinë 1)
Gjenerimi i të ardhurave nëpërmjet transaksioneve në treg	Shitja ose dhënia me qira e tokës	Preuređenje gradskog zemljišta
Gjenerimi i të ardhurave nëpërmjet taksave	Taksat e përgjithshme, p.sh. TVSH, taksa mbi pronën	Mbushja e plazhit me rërë (Sophiastrand, Holandë) Gjelbërimi i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet urbane (Plani i Menaxhimit për Rrebeshet në Kopenhagë)

Mesazhi kyç: Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë mund të mobilizojnë investimet private për shkak të përfitimeve të përbashkëta që ato prodhojnë, duke reduktuar kështu nevojat për investime totale publike në PNK/RRF

Një mekanizëm kyç për shfrytëzimin e investimeve publike në ZBN është investimi privat shtesë që mund të mobilizohet përmes tërheqjes financiare për ta bërë këtë për aktorët privatë. ZBN-të për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë mund të mobilizojë gjithashtu investime private shtesë për shkak të gamës së përfitimeve ekonomike, sociale dhe mjedisore që ato prodhojnë. Në të vërtetë, cilësia e përmirësuar mjedisore e prodhuar nga ZBN-të mund të krijojë kushtet për modele të suksesshme biznesi, të tilla si eko-turizmi, pylltaria e qëndrueshme, peshkimi dhe akuakultura e qëndrueshme, bletaria ose bujqësia e qëndrueshme (shih Rastin Studimor: Parku Natyror Lonjsko Polje).

ZBN-të duhet projektuar për të rritur mundësitë për mobilizimin e investimeve shtesë të sektorit privat, duke krijuar kushte që lejojnë lulëzimin e bizneseve të gjelbra. Kushtet e tilla për promovimin e sipërmarrjes së gjelbër mbulojnë një sërë faktorësh, duke përfshirë:

- Rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me mundësitë e biznesit të gjelbër ndër radhët e popullsisë vendore;
- Ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimet për sipërmarrjen e gjelbër, duke përfshirë përdorimin e p.sh. Kanavacës së Modelit të Biznesit (Business Model Canvas) ose mjete të tjera;
- Rrjetëzimin, shkëmbimin e përvojave dhe të nxënimit ndërmjet Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM-ve) dhe in-

vestuesve të mundshëm (p.sh. kombinimeve) në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, si dhe në kontekste të tjera përkatëse kombëtare;

- Stimuj dhe mbështetje financiare (p.sh. mbulimi i kostove të hapjes së biznesit, trajnimeve, pagesat e sigurimeve shoqërore, stimujve tatimorë) për koston e themelimit dhe hapjes së një biznesi të ri në fazat fillestare të biznesit të gjelbër.

Kutia 1. Mobilizimi i investimeve të jashtme në Parkun Natyror Lonjsko Polje, Kroaci

Një Park Natyror u krijua në Lonjsko Polje, i cili ndodhet në pellgun e lumit Sava, në pjesën veri-qendrore të Kroacisë. Ai përfshin 14 vendbanime dhe me 50,650 ha është një nga zonat ligatinore më të mëdha të mbrojtura në pellgun e Danubit. Zona përballet me një sërë sfidash të ndryshimeve klimatike duke përfshirë përmbytjet në rritje, si dhe thatësitrat ekstreme dhe ndryshimet në komunitetet e bimëve që kërkojnë qasje të reja menaxhimi.

Parku Natyror Lonjsko Polje u krijua me qëllimin për të siguruar zonën si një vend të dëshirueshëm për të jetuar përmes biodiversitetit, mbrojtjes së peizazhit dhe kulturës, mbështetjes për praktikat ekzistuese të përdorimit të tokës për ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të fermave të vogla familjare dhe turizmit. Duke vepruar kështu, ai siguron disa përfitime për zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike. Këto përfshijnë shfrytëzimin e zonave të përmbytjeve natyrore si zona mbajtjeje, reduktimin e CO2 përmes restaurimit të pyjeve të zonave të përmbytura bregore, rimbushjen e ujërave nëntokësore dhe përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm. Parku Natyror Lonjsko Polje është themeluar përmes financimit të pushtetit qendror (70%), buxhetit të vetë projekteve (15%) dhe fondeve shtesë të siguruar përmes donacioneve dhe granteve nga OJQ-të ose sektori privat (15%). Projekti, për rrjedhojë, nxiti investimet publike duke krijuar burime të ardhurash për operatorët e


fermave rurale dhe turistike të sektorit privat, ndërkohë që redukton kostot e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet në pellgun e lumit Sava.

Përmes qasjes së ruajtjes ZBN, adresohen njëkohësisht një sërë objektivash, duke përfshirë menaxhimin e ujit, pyjeve dhe kullotave, ndërkohë që lejon gjithashtu ruajtjen e vlerave të peizazhit që mund të mbështesin gjenerimin e të ardhurave nëpërmjet aktiviteteve turistike.

Lidhur me menaxhimin e ujit, për shembull, ZBN-të bazohen në ruajtjen e funksionit bazë të zonave të përmbytjes natyrore nëpërmjet mbrojtjes së vlerave biologjike dhe peizazhore së bashku me modifikimet më konvencionale të Sistemit të Kontrollit të Përmbytjeve (zgjidhje hibride). Në të gjithë sipërfaqen e Parkut Natyror, 82% e së cilës gjendet në zonën e përmbytjes, 25,630 ha përbëhet nga zona e kontrolluar e mbajtjes së ujit nga përmbytjet, p.sh. përmes portave të kanalizimeve, mureve të mbajtjes së ujit, etj., dhe 20,600 ha mbështetet në proceset e pakontrolluara të përmbytjeve natyrore. Qasja redukton dëmet nga përmbytjet me kosto më të ulët se metodat tërësisht konvencionale, duke ruajtur gjithashtu vlerat e peizazhit që mund të tërheqin turizmin rural.

Për sa i përket kullotave, të cilat përbëjnë 20% të sipërfaqes së parkut, nisma mbështet sistemet tradicionale të kullotave si një qasje e dobishme për menaxhimin e burimeve natyrore për disa arsye. Për kullotje, racat vendase kanë treguar se janë përshtatur më së miri me kushtet e habitatit, ndërkohë që ruhet gjithashtu edhe peizazhi i zonës. Më tej, kullotja tradicionale ofron përfitime nga turizmi rural për shkak të cilësisë së produkteve të prodhuara dhe kërkesës për peizazhe tradicionale nga turistët ruralë.

Figura 1. ZBN-të në Parkun Natyror Lonjsko Polje (Parku Natyror Lonjsko Polje, 2019).



Mesazhi kyç: Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë mund të tërheqin financa të jashtme ndërkombëtare për klimën dhe zhvillimin me një mandat për të shmangur rrezikun e investimeve private për projektet e natyrës dhe klimës

Një mekanizëm tjetër kyç për shfrytëzimin e investimeve publike në PNK/RRF nëpërmjet ZBN-ve është tërheqja e investimeve të jashtme nga institucionet ndërkombëtare të financimit të zhvillimit me mandat për të mbështetur projektet që lidhen me natyrën dhe klimën. Një investim i tillë i jashtëm mund të zvogëlojë drejtpërdrejt kostot e përgjithshme të projektit për qeveritë duke mbuluar një pjesë të këtyre kostove, si dhe duke mobilizuar investime të mëtejshme private nëpërmjet marrëve-

shjeve të financimit të përzier që përfshijnë shmangien e rrezikut të projektit dhe duke e bërë atë më tërheqës për investuesit privatë. Financat e përziera i referohen përdorimit strategjik të financave të zhvillimit për mobilizimin e financave shtesë drejt zhvillimit të qëndrueshëm në vendet në zhvillim (OECD 2020a). Donatorët (ose fondacionet) mund të hyjnë në marrëveshje financimi të përziera përmes instrumenteve të ndryshme (p.sh. grante, kapital, partneritet publik-privat, garanci, etj.) në mënyrë që të mobilizojnë burime shtesë për objektivat e klimës ose të biodiversitetit.

Për financimin e biodiversitetit relevant për ZBN-të, donatorët dypalësh janë ofruesit kryesorë të financave të jashtme, pasi flukset dypalëshe janë afërsisht 10 herë më të mëdha se flukset shumëpalëshe (Deutz et al. 2020). Megjithatë, financimi shumëpalësh i zhvillimit është gjithashtu i rëndësishëm si nëpërmjet granteve ashtu edhe përmes marrëveshjeve të financimit të përzier. Për shembull, Fondi i Gjellbër i Klimës (GCF), si instrumenti kryesor i financimit ndërkombëtar të klimës, ka një mandat të qartë për të mbështetur projektet klimatike si dhe për të shmangur rrezikun për të mobilizuar investime private shtesë drejt objektivit të UNFCCC prej 100 miliardë dollarësh në financimin total për klimën për vendet në zhvillim çdo vit. Më tej, Fondi Global i Mjedisit (GEF) është një nga donatorët më të rëndësishëm me 1.3 miliardë dollarë të ciklit aktual të rehabilitimit prej 4.1 miliardë dollarësh (2018-2022) të angazhuar për biodiversitetin.

Mundësi të kombinuara financimi për ZBN-të në përgjithësi duhet të synojnë fondacionet ose investuesit e tjerë me ndikim pasi investuesit tregtarë janë më pak të spikatur. Ndryshe nga financimi i klimës, ku më shumë se gjysma e investimeve vijnë nga burime private në nivel global (CPI 2019), biodiversiteti mbështetet kryesisht në financat publike, me vetëm 14 për qind të investimeve që vijnë nga burime private në nivel global. Një përjashtim i dukshëm për këtë janë modelet e biznesit për ZBN-të që përfshijnë zonat e ruajtjes, ku përfitimet e zbutjes shiten përmes kompensimit të karbonit. Tërheqja e financave të përziera si përmes institucioneve financiare ndërkombëtare, ashtu edhe investuesve ose fondacioneve private mund të lehtësohet duke

hartuar ZBN në përputhje me Standardin Global të IUCN-së për Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (IUCN, 2020).

Mesazhi kyç: Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë mund të nxisin investimet publike duke prodhuar përfitime të përbashkëta, të tilla si përmirësimi i cilësisë mjedisore, që gjenerojnë të ardhura tatimore nga aktivitetet e shtuara rekreative.

Një mekanizëm tjetër kyç për shfrytëzimin e investimeve publike në PNK/RRF nëpërmjet ZBN-ve është se aktori publik, p.sh. autoritetet bashkiake, rajonale ose kombëtare që iniciojnë një ZBN, mund të rikuperojë disa nga kostot e investimit duke rritur të ardhurat e tij nga taksat nga rritja e aktiviteteve ekonomike që rrjedhin nga ZBN-të. Rritja e aktiviteteve ekonomike në përgjithësi ndodh për shkak të përfitimeve të përbashkëta të prodhuara nga një ZBN duke e bërë një zonë më tërheqëse nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së mjedisit, e cila mund të mbështesë rritjen e turizmit ose aktivitete të tjera si peshkimi, pylltaria ose bujqësia e qëndrueshme. Ndërsa këto aktivitete prodhojnë përfitime private dhe burime të ardhurash të lidhura me to, disa prej tyre mund të përftohen nga aktorët publikë nëpërmjet instrumenteve tatimore, duke rikuperuar kështu një pjesë të investimit publik fillestar në ZBN dhe duke arritur kthime më të mëdha nga investimi për aktorin publik (Shih Rastin Studimor Sophiastand).

Kutia 2. Gjenerimi i të ardhurave tatimore nga përfitimet e përbashkëta të ZBN-ve në Restaurimin e Peizazhit Pyjor në Kraljevo, Serbi

Në Kraljevo, Serbi, projekti ADAPT inicioi një projekt pilot mbi opsionet e restaurimit të peizazhit pyjor (RPP) në arritjen e zbutjes së përmbytjeve dhe reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë. Një analizë kosto-përfitim (AKP) u krye për të identifikuar opsionet më tërheqëse të RPP-së dhe për të ofruar një arsyetim për zbatimin e RPP-së në krahasim me skenarin bazë 'biznes-si-zakonisht' (shih Përmbledhjen e Politikave Ekonomike). Një rezultat kyç i AKP-së ishte një analizë e flukseve financiare që do të krijoheshin duke zbatuar masat e RPP-së në krahasim me gjendjen fillestare.

Kostot financiare dhe përfitimet e lidhura me skenarin bazë të biznesit si zakonisht janë paraqitur në tabelën 1. Treguesit për kostot janë grupuar në kosto private, kosto publike direkte dhe kosto publike indirekte nga fatkeqësitë dhe erozioni. Treguesit për përfitime u grupuan në përfitime private dhe përfitime publike, secila prej të cilave shprehet në flukse monetare aktuale. Për analizën financiare, është e rëndësishme të përqendrohemi në kostot dhe të ardhurat nga masave që i përkasin një aktori të posaçëm (në këtë rast, Bashkisë). Prandaj, analiza financiare për aktorin publik përqendrohet në kostot publike direkte dhe përfitimet publike, secila prej të cilave shprehet në flukse monetare dhe janë theksuar në tabelën 1. Kostot publike indirekte nuk rezultojnë në flukse monetare aktuale dhe për këtë arsye nuk përfshihen në analizën financiare. Tabela 1 tregon se skenari i gjendjes fillestare në Kraljevo ka një ndikim pozitiv në qarkullimin e parave për qeverinë, gjë që shpjegon pjesërisht situatën ekzistuese. Analiza e mëtejshme e opsioneve ZBN zbuloi se RPP-të e tjera kishin ndikim financiar edhe më pozitiv në buxhetin publik nëpërmjet instrumentit të dhënies së tokës me qira, turizmit dhe taksës mbi pronën të paraqitur në Tabelën 1 (shih IUCN (2021) për detaje).

Ky përqendrim në kostot financiare dhe të ardhurat për qeverinë mund të krahasohet me analizën ekonomike, e cila llogarit të gjitha përfitimet (d.m.th. edhe ato që nuk rezultojnë në flukse mo-

netare aktuale). Duke u përqendruar në flukset aktuale të parasë për qeverinë përgjegjëse për zbatimin e masës, arrihet një pamje realiste e ndikimeve buxhetore të një mase të caktuar, dhe në këtë rast, jepet një arsyetim i mëtejshëm për zgjedhjen e masave ZBN për shkak të ndikimit pozitiv të ZBN-së mbi buxhetin publik krahasuar me skenarin e biznesit si zakonisht. Më tej, përqendrimi në aspektet financiare të masës për një aktor të posaçëm (d.m.th. flukset aktuale të parasë) ofron një bazë për përcaktimin e një plani financimi për masën ZBN. Për shembull, një analizë e tillë financiare mund të lehtësojë qasjen në kredi (përfshirë financimin e klimës) duke demonstruar flukset e ardhshme të parasë që do të zhblokohen nga një ndërhyrje ZBN.

Tabela 1. Treguesit financiarë në skenarin e gjendjes fillestare për AKP-në në Kraljevo, Serbi. (burimi : IUCN, 2021). Rreshtat me ngjyrë të theksuar janë të rëndësishme për analizën financiare.

Item	Njësia	Çmimi për Njësi EUR	Sasia	Gjithsej EUR	Intervali Kohor	Gjithsej në Vit EUR
Kostot Private						14.958.365,02
Taksa mbi Pronën	Familje	8,84	14908	131.750,00	i përvitshëm	131.750,00
Ujësllësi	Familje	130,73	901	117.787,73	Muaj	1.413.452,76
Mirëmbajtja e Zonave Pyjore	EUR/ha	1.486,52	6701,03	9.961.231,87	i përvitshëm	9.961.231,87
Kostot Publike						486.501,72
Kostot për Mbrojtjen Civile	EUR	0,61	14908	9.073,62	i përvitshëm	9.073,62
Organizata Turistike	EUR	1,45	14908	21.522,91	i përvitshëm	21.522,91
Management Costs						455.905,18
Stafi SG "Stolovi"	Pagë	741,57	36	26.696,66	Muaj	320.359,97
Stafi LSG Kraljevo	Pagë	706,82	3	2.120,45	Muaj	25.445,43
Mirëmbajtja e Zonave Pyjore	EUR/ha	48,81	2256	110.099,79	i përvitshëm	110.099,79
Kostot për Fatkeqësitë Natyrore						1.364.356,11
Dëmi nga Fatkeqësitë Natyrore						1.364.356,11
Infrastruktura për Kategori	Njësi	e paaplikueshme	e paaplikueshme	1.364.356,11	i përvitshëm	1.364.356,11
Erozioni						9.553,79
Degradimi i Tokës	M3/ha	e paaplikueshme	e paaplikueshme	9.553,79	Vit	9.553,79
Sekuestrimi i CO2						10.139.763,99
Sekuestrimi i Karbonit	T/Ha	5,92	1714498	10.139.755,49	Vit	10.139.763,99
Përfitimet Private						6.004.817,72
Të Ardhurat Vetjake						5.909.379,72
Të Ardhurat Vetjake nga Bujqësia	Pagë	585,00	289	169.065,42	Muaj	2.028.785,03
Të Ardhurat Vetjake nga Pyjet	Pagë	580,29	432	250.683,77	Muaj	3.008.205,22
Të Ardhurat Vetjake nga Turizmi	Pagë	390,86	186	72.699,12	Muaj	872.389,48
Subvencionet	EUR/ha	34,00	2807	95.438,00	i përvitshëm	95.438,00
Përfitimet Publike						655.488,15
Dhënia e Tokës me Qira	EUR	na		918,00	i përvitshëm	918,00
Tarifat për Tokën Bujqësore	EUR	na		6.885,00	i përvitshëm	6.885,00
Turizmi	Numri i tarifave	na		10.166,09	i përvitshëm	10.166,09
Taksa mbi Pronën	EUR	na		412.250,00	i përvitshëm	412.250,00
Lënda Drusore	EUR	na		225.269,07	i përvitshëm	225.269,07

Mesazhi kyç: Promovoni dhe integroni burime të dedikuara financimi për ZBN-të në politika dhe planifikim, pasi financimi i ZBN-ve mbetet një mangësi e rëndësishme.

Pavarësisht përfitimeve të përbashkëta të shumta që ofrohen nga ZBN-të dhe burimet e ndryshme të gjenerimit të të ardhurave që ato mund të ofrojnë, siç u diskutua më lart, planifikimi financiar për ndërhyrjet ZBN mbetet një mangësi e madhe në politikat e Ballkanit Perëndimor. Edhe kur planet ose politikat ekonomike ose sektoriale përmendin në mënyrë të qartë ZBN-të, rrallë gjenden në zbatim marrëveshje të hollësishme financiare ose burime financimi për të siguruar zbatimin e tyre (Bisaro dhe Meyer, 2022). Duhet të ndiqen një sërë instrumentesh novatore financimi, duke përfshirë fondet e dedikuara për ZBN-të, Pagesat për Shërbimet e Ekosistemit (PSHE) dhe partneritetet publiko-private, si dhe instrumente tatimore të dedikuara qoftë në nivele ekonomike, vendore apo urbane. Në të vërtetë, një qasje efektive për gjenerimin e flukseve të të ardhurave për financimin e ZBN-ve është përmes zhvillimit në bazë të instrumenteve ekzistuese tatimore ose marrëveshjeve për tarifën e përdoruesve nëpërmjet tarifave shtesë ose tarifave mjedisore për ata pronarë tokash ose operatorë biznesi që mund të përfitojnë nga ZBN-të. Një rast studimor për tarifën mbi ujërat e stuhisë të vendosura në Kopenhagë për të financuar menaxhimin e gjelbër të rrezikut të përmblytjeve urbane (shih Kutinë 3) më poshtë diskuton një shembull të tillë.

Kutia 3. Gjenerimi i të ardhurave përmes tarifave të ujërave të stuhisë për menaxhimin e gjelbër të përmblytjeve urbane në Kopenhagë

Kopenhaga është një qytet bregdetar me rreth 800,000 banorë, i cili përjeton përmblytje nga shiu i shkaktuar përmes stuhive të rrebesheve të befta dhe është i ekspozuar ndaj rrezikut të rritjes së nivelit të ujit të shkaktuar nga stuhitë si edhe përkeqësimit të situatës nga rritja e nivelit të detit. Ngjarjet e rënda të reshjeve në verën e viteve 2010 dhe 2011 bënë që bashkia të ndërmernte prioritizimin e një Plani të Menaxhimit të Rrebesheve të Befta, i cili ishte identifikuar tashmë si një prioritet në Planin e Përshtatjes Klimatike të qytetit. Aty ku Plani i Përshtatjes Klimatike bëri rekomandime duke u përqendruar në rritjen e kapacitetit të ruajtjes dhe depozitimit të ujit të shiut, ngjarjet e shpërthimit të rrebesheve në vitin 2010 dhe 2011 treguan se këto masa nuk do të ishin të mjaftueshme për të reduktuar rrezikun nga ngjarjet ekstreme të reshjeve. Studimet e mëvonshme zbuluan se masat e ruajtjes duhej të plotësoheshin me masa kullimi në shkallë të gjerë për të lejuar që uji i stuhisë të derdhej në det nëpërmjet rrugëve, kanaleve, kalimeve ujore urbane dhe madje edhe tuneleve të dedikuara. Kështu, Plani i Menaxhimit të Rrebesheve përfshin një grup masash hibride që kombinojnë hapësirat publike me rritjen e kapacitetit të kullimit të ujit, disa nga masat janë në përputhje me konceptin e ZBN-ve, si p.sh., parqet urbane dhe kanalet që mund të përdoren si kalime kulluese natyrore gjatë ngjarjet madhore të reshjeve.

Plani i Menaxhimit të Rrebesheve përfshin një përzjerje masash, duke përfshirë tunelet konvencionale të kullimit, si dhe zgjidhjet e kullimit ZBN të integruara në infrastrukturën e qytetit. Kostot e investimit për të gjitha masat e zbatuara në një hark kohor prej 20 vjetësh, u vlerësuan në 3.8 miliardë DKK (510 milionë euro) në vlerën aktuale në vitin 2012 (Bashkia e Kopenhagës, 2012). Struktura e financimit të masës së

infrastrukturës në plan përfshin dy burime: tarifën e ujit nga ujësjellësi dhe taksat nga bashkia. Përzierja e saktë e kontributeve nga tarifën e ujësjellësit, ose taksave të bashkisë, varet nga masa që do të zbatohet. Për masat konvencionale që kanë vetëm funksion kullimi, si p.sh. tunelet e kullimit, financimi vjen tërësisht nga tarifën e ujësjellësit. Për masat "e gjelbra" që integrojnë kullimin ose depozitimin e ujit me përdorime të tjera, të tilla si rrugët ose parqet e qytetit, një përzierje e tarifave të ujësjellësit dhe taksave të bashkisë përdoren për të financuar masat. Me anë të masave të tilla, bashkia ndërton dhe operon masën dhe merr fonde nga tarifa e ujësjellësit në proporcion me kostot e investimeve për masën që i atribuohet rreptësisht menaxhimit të mbetjeve ose ujërave të stuhisë. Pjesa e mbetur e kostove të masës mbulohet nga bashkia.

Kostot shtesë për infrastrukturën e menaxhimit të stuhisë dhe ujërave të zeza të Planit për mbrojtjen nga rreziku i përmbajtjeve deri në nivelin e ngjarjeve që ndodhin 1-100 vjet janë për rrjedhojë përgjegjësi e shoqërisë së ujësjellësit (Københavns Energji). Kostot e investimit të shoqërisë financohen nga të ardhurat e tarifave të ujit, të cilat konsistojnë në tarifën e kullimit të paguar për metër kub ujë të blerë nga shoqëria. Kështu, kostot shtesë të investimit të Planit për shoqërinë financohen nëpërmjet një rritjeje të tarifës së ujit që do të ketë një ndikim vjetor mbi familjet të llogaritur me një shtesë prej 200-300 euro.

Figura 3 ilustron strukturën e financimit të projektit, duke treguar se kështu projekti mbështetet në një strukturë tërësisht të bazuar në marrjen e vlerës nga tarifa e përdoruesit të ujit, dhe instrumentet e përgjithshme të taksave të bashkisë që marrin një pjesë të vlerës së investimeve për reduktimin e rrezikut dhe vlera e komoditetit rritet për shkak të përfitimeve të përbashkëta nga masa. Bashkia dhe ujësjellësi kryejnë investime paraprake në infrastrukturën e gjelbër që ofron përfitime të drejtpërdrejta për reduktimin




Figura 3. Marrëveshjet e financimit, investimet dhe rrjedhat e të ardhurave në Planin e Menaxhimit të Rrebesheve të shiut. (Bisaro, 2021).

e rrezikut nga përmbajtjet, si dhe përfitime të përbashkëta nga përmirësimi i komoditeteve në qytet për shkak të shtimit të hapësirave të gjelbra. Të gjitha masat duhet të plotësojnë një standard të sigurisë 1-100 vjet gjatë kohëzgjatjes së tyre. Kështu, analiza kosto-përfitim e departamentit të planifikimit në bashki duke krahasuar masat tradicionale të kullimit të infrastrukturës 'gri', si tunelet nëntokësore të kullimit, me masat 'e gjelbra', zbuloi se përfshirja e masave të gjelbra reduktoi ndjeshëm kostot e planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbajtjet për shkak të rrebesheve, megjithëse humbjet e shmangura ishin të njëjta për masat e marra gri dhe të gjelbra, sepse të gjitha masat duhet të përmbushnin të njëjtin standard sigurie.

Referencat

- Bisaro, A., Meyer, K., 2022. Integrating Nature-based Solutions into Policies for Climate Change Adaptation and Disaster Risk Reduction. A Regional Comparative Policy Analysis in the Western Balkans (ADAPT project). IUCN.
- Bisaro, A. 2021. Mobilising finance for coastal adaptation in cities. C40, New York, USA.
- IPCC, 2014. Summary for policymakers, in: Field, C.B., Barros, V., Dokken, D.J., Mach, K.J., Mastrandrea, M.D., Bilir, T.E., Chatterjee, M., Ebi, K.L., Estrada, Y.O., Genova, R.C., Girma, B., Kissel, E.S., Levy, A.N., MacCracken, S., Mastrandrea, P.R., White, L.L. (Eds.), Climate Change 2014: Impacts, Adaptation and Vulnerability. Part A: Global and Sectoral Aspects. Contribution of Working Group II to the Fifth Assessment Report of the Intergovernmental Panel on Climate Change. Cambridge University Press, Cambridge, UK and New York, USA, pp.1-32.
- IUCN, 2021. Forest Landscape Restoration Opportunities Assessment, Municipality of Kraljevo, Serbia. IUCN ECARO.
- IUCN, 2020. IUCN Global Standard for Nature-based Solutions : first edition.
- IUCN, 2016. Nature-based solutions to address global societal challenges. IUCN, Gland, Switzerland.
- Lonjsko Polje Nature Park, 2019. Management of the Lonjsko Polje Nature Park. Lonjsko Polje Nature Park Public Institution.
- OECD, 2020. Climate Finance Provided and Mobilised by Developed Countries in 2013-18, Climate Finance and the USD 100 Billion Goal. OECD. <https://doi.org/10.1787/f0773d55-en>
- UNISDR, 2017. Words into Action Guidelines -- National focal points for Disaster Risk Reduction.

Burime të mëtejshme

- Restoration Opportunities Assessment Methodology (ROAM): <https://www.wri.org/research/restoration-opportunities-assessment-methodology-roam>
- United Nations Environmental Assessment (UNEA) resolution on Nature-based Solutions: <https://wedocs.unep.org/bitstream/handle/20.500.11822/39864/NATURE-BASED%20SOLUTIONS%20FOR%20SUPPORTING%20SUSTAINABLE%20DEVELOPMENT.%20English.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

Përmbledhja e politikave: Qeverisja e Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë

**ADAPT: Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë për shoqëritë me aftësi
ripërtëritëse në Ballkanin Perëndimor**

IUCN ECARO

Autor:

Alexander Bisaro

Recensentë:

Mihaela Dragan-Lebovics, Kristin Meyer, Cate Owren, Jackie Siles

Mesazhet kyçe.....	46
Hyrje	48
Mesazhi kyç: ZBN-të duhet të bazohen në qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe fuqizuese (Kriteri 5).....	51
Kutia 1. Analiza gjinore për identifikimin e masave të Restaurimit të Peizazhit Pyjor në Kraljevo, Serbi	52
Mesazhi kyç: hartimi i ZBN-ve duhet të përfshijë nevojën për të balancuar kompromiset (Kriteri 6)	56
Kutia 2. Mjetet e vlerësimit të kompromiseve ekonomike dhe natyrore për projektimin e ZBN-ve: ZBN-të për përshtatjen ndaj rritjes së nxhehtësisë urbane	58
Mesazhi kyç: projektimi i ZBN-ve duhet të përfshijë marrjen në konsideratë të integritetit dhe qëndrueshmërisë (Kriteri 8)	60
Referencat	63
Burime të mëtejshme	63

Mesazhet kyçe

- ZBN-të duhet të bazohen në qeverisje të bazuar në të drejta dhe fuqizuese, e cila duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe transparente për t'u siguruar të gjitha palëve të interesuara informacion dhe mundësi për pjesëmarrje, për të ushtruar ndikim dhe për të përfituar nga ZBN-të.**

Qeverisja e barabartë dhe fuqizuese duhet të marrë parasysh dinamikat e fuqisë socio-kulturore dhe të krijojë kushte të favorshme për pjesëmarrje, përfshirje të qëndrueshme dhe rritje të aftësive drejtuese të atyre shtresave të margjinalizuara në mënyrë të pabarabartë. Kjo mund të përfshijë në mënyrë të domosdoshme dispozita për adresimin e pengesave strukturore për përfshirjen e burrave, grave dhe njerëzve jo binarë me prejardhje të ndryshme. Qeverisja transparente dhe gjithëpërfshirëse mbështet rritjen e ndërgjegjësimit mbi rreziqet e natyrës dhe ndryshimet klimatike dhe mundëson rezultate të përmirësuara në të gjithë sektorët.

- Qasjet e qeverisjes së bazuar në të drejta dhe fuqizuese duhet të sigurojnë që pjesëmarrja të bazohet në respektin dhe barazinë reciproke, pavarësisht gjinisë, moshës apo statusit social, dhe të mbrojtë të drejtat e popujve indigjenë.**

Kjo kërkon një përpjekje të vetëdijshme për të përfshirë në mënyrë aktive grupet e përjashtuara tradicionalisht në proceset e vendimmarrjes në mënyrë të tillë që të ruhet dinjiteti i tyre dhe të inkurajohet pjesëmarrja e tyre. Analiza gjinore është një komponent kyç për mbështetjen e qeverisjes gjithëpërfshirëse.

- Qeverisja gjithëpërfshirëse mund të përmirësohet përmes projektimit dhe zbatimit të proceseve për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave që marrin parasysh perspektiva të ndryshme dhe angazhojnë në mënyrë aktive qytetarë të ndryshëm dhe rrisin ndërgjegjësimin e tyre për çështjet e adresuara nga ZBN-të.**

Analizat gjinore dhe të palëve të interesuara janë dy mjetet për rritjen e ndërgjegjësimit. Përveç kësaj, po shfaqen një sërë qasjesh të shkencës qytetare që përfshijnë, për shembull, përdorimin e GIS-it ose

modelimin ekologjik dhe ekonomik në mbështetje të mjeteve novatore për mbledhjen e të dhënave.

- Projektimi i ZBN-ve duhet të përfshijë nevojën për të balancuar kompromiset.**

Kompromiset ndodhin sepse ZBN-të shpesh ofrojnë një shumëllojshmëri përfitimesh të ndryshme dhe jo të gjithë palët e interesuara i vlerësojnë këto përfitime në të njëjtën mënyrë. Kompromiset mund të shfaqen midis objektivave të ndryshëm ekonomikë, socialë dhe të biodiversitetit në ZBN. Adresimi i tyre duhet të qaset në mënyrë transparente përmes vlerësimeve të hapura e të besueshme dhe marrëveshje midis palëve më të prekura, dhe me masa mbrojtëse ekologjike dhe sociale që njohin gjithashtu rëndësinë e integritit të masave dhe strategjive të përgjigjshme gjinore. Një sërë mjeteve analitike të reja dhe novatore po shfaqen për të vlerësuar këto kompromise dhe për të mbështetur proceset gjithëpërfshirëse të vendimmarrjes në lidhje me kufijtë dhe masat mbrojtëse të kompromiseve.

- Projektimi i ZBN-ve duhet të përfshijë marrjen në konsideratë të integritit dhe qëndrueshmërisë.**

Është e rëndësishme të sigurohet që ZBN-të të mbështeten nga kuadro mundësuese institucionale dhe politike, duke përfshirë sektorë të ndryshëm. Një mjedis i favorshëm nxit të kuptuarit e ndërvarësisë ndërmjet objektivave të politikave dhe i paraprin identifikimit të ZBN-ve elastike, novatore dhe të posaçme të nivelit vendor. Në këtë mënyrë, ZBN-të janë arsyeja e qëndrueshmërisë afatgjatë për të siguruar që rezultatet të zgjasin përtej afatit të kufizuar kohor të një ndërhyrjeje të posaçme. Më tej, ZBN-të duhet të integrohen në mënyrë që ato të lehtësojnë përfshirjen e mëtejshme në politikë dhe praktikë. Kjo përfshin rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për ZBN-të, sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve përkatëse të interesit dhe promovimin e mundësive për komunitetet vendore për të drejtuar dhe ndikuar, për të përfituar drejtpërdrejt si dhe për të investuar bashkërisht në ZBN.

- Integrimi i ZBN-ve kërkon mobilizimin e financave për zbatimin e ZBN-ve.**

Një integrim i tillë kërkon buxhete të dedikuara për ZBN-të, dhe në këtë mënyrë një koordinim të ngushtë me Ministritë e Financave.

Hyrje

Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZBN) po fitojnë rëndësi në mbarë botën si masa me kosto të mundshme efektive që ofrojnë njëkohësisht përfitime mjedisore, sociale dhe ekonomike dhe ndihmojnë në ndërtimin e aftësisë ripërtëritëse. Në të vërtetë, gjatë Asamblesë së Mjedisit të Kombeve të Bashkuara, mbajtur në Nairobi në vitin 2022, liderët botërorë miratuan një rezolutë mbi Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë për Mbështetjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Rezoluta u bën thirrje shteteve anëtare të mbështesin zbatimin e ZBN-ve në partneritetet me komunitetet vendore, gratë, të rinjtë dhe popujt indigjenë dhe aplikimin e një qasjeje të drejtuar nga vendi, të përgjigjshme gjinore, pjesëmarrëse dhe plotësisht transparente. Për rrjedhojë, ZBN-të ofrojnë potencial për të sjellë karakteristika dhe procese të ndryshme natyrore në qytete, peizazhe tokësore dhe detare, dhe adresojnë një sërë sfidash shoqërore, duke përfshirë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë (Seddon et al., 2020).

Duke pasur parasysh potencialin dhe rritjen e kërkesës për ZBN-të, ekziston nevoja për të vendosur një sërë kriteresh për të përcaktuar se cilat ndërhyrje, masa apo projekte janë në fakt ZBN. Në mungesë të kriterëve të tilla, shfaqen rreziqe për keqpërdorimin e konceptit ZBN, duke shkaktuar më shumë dëm sesa përmirësim të shoqërive, komuniteteve dhe natyrës. Projektimi dhe zbatimi i duhur i ZBN-ve kërkon marrjen në konsideratë të një sërë çështjesh të ndërlikuara të ndërvarësisë midis shkallëve, sektorëve, komuniteteve dhe ekosistemeve. Më tej, mungesa e marrjes parasysh të faktorëve socialë dhe ekonomikë – për shembull pabarazia gjinore – mund të nënkuptojë se edhe ndërhyrjet fillestare të suksesshme ZBN përfundimisht mund të mos jenë të qëndrueshme ose në fakt mund të shkaktojnë dëm për komunitetet ose popullatat e veçanta brenda komuniteteve. Në planin afatgjatë, projektet ZBN të etiketuara gabim ose të projektuara keq mund të zbehin rastin për qasjen ZBN - duke çuar në një lëkundje të besimit për përdorimin e saj dhe në mundësi të humbura për mbrojtjen, restaurimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ekosistemeve për përfitimet e natyrës dhe njerëzve.

Standardi Global i IUCN-së për Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë u zhvillua për të plotësuar këto boshllëqe dhe për të adresuar këto rreziqe të mundshme. Në të vërtetë, Standardi synon të mbështesë institucione, investues dhe vendimmarrës në identifikimin e nismave ZBN që janë efektive dhe të shkallëzueshme, të parandalojë keqpërdorimet dhe të marrë në konsideratë pasojat e mundshme. Në veçanti, nëpërmjet grupit të kriterëve dhe treguesve që lehtësojnë projektimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e ZBN-ve, Standardi mbështet vendimmarrësit, të cilët mund të jenë të kufizuar në qasjen e tyre në gamën e gjerë të ekspertizës së nevojshme për këtë qëllim, në analizimin e projekteve ZBN (p.sh. mbi ekosistemet, qeverisjen, barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale, ekonominë dhe financat).

Përkufizimet kyçe

Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZBN) janë veprime për të mbrojtur, menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe restauruar ekosistemet natyrore ose të modifikuara, që adresojnë sfidat shoqërore në mënyrë efektive dhe të përshtatur, duke siguruar njëkohësisht mirëqenien njerëzore dhe përfitimet nga biodiversiteti (IUCN, 2016).

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është procesi i përshtatjes me klimën aktuale ose të pritshme dhe pasojat prej saj. Në sistemet njerëzore, përshtatja kërkon të zbusë ose shmangë dëmin, ose të shfrytëzojë mundësitë e dobishme. Në disa sisteme natyrore, ndërhyrja njerëzore mund të lehtësojë përshtatjen me klimën e pritshme dhe pasojat prej saj (IPCC, 2014).

Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë ka për qëllim parandalimin e rrezikut të ri dhe reduktimin e rrezikut ekzistues të fatkeqësive (ekspozimi, rreziku ose cenueshmëria) dhe menaxhimin e rrezikut të mbetur, të gjitha këto kontribuojnë në forcimin e elasticitetit dhe rrjedhimisht në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm (IPCC, 2014; UNISDR, 2017).

Kjo Përmbledhje e Politikave përqendrohet veçanërisht në dimensionet e qeverisjes së Standardit Global të IUCN-së për Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë. Ajo synon t'u ofrojë politikë-bërësve një kuadër logjik për qasjet gjithëpërfshirëse të bazuara në të drejta ndaj ZBN-ve, si dhe shembuj praktikë se si këto qasje zbatohen në praktikë.

Qeverisja është e rëndësishme për disa arsye. Para së gjithash, qeverisja e mirë është e nevojshme për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut. Sigurimi i qasjeve të bazuara në të drejta, të përgjigjshme ndaj gjinisë dhe gjithëpërfshirëse shoqërore për identifikimin, ndikimin, përfshirjen dhe përfitimin nga ZBN-të është thelbësor për qëndrueshmërinë afatgjatë të ZBN-ve për një planet të shëndetshëm, paqësor dhe elastik. Së dyti, qeverisja e mirë e ZBN-ve mund të ketë gjithashtu ndërlikime për përfshirjen e ZBN-ve në politikat dhe sektorët përkatës në nivele të ndryshme të qeverisjes, veçanërisht duke pasur parasysh se shfrytëzimi i plotë i mundësive për integrim është një karakteristikë e projektimit të mirë të ZBN-ve. Së treti, shumë institucione financiare, donatorë dhe investues të tjerë janë të shqetësuar për qeverisjen e mirë të projekteve që ata mbështesin, dhe kështu qeverisja e mirë duhet të konsiderohet në fazën fillestare të projektimit të ZBN-ve në mënyrë që të tërheqë financat e nevojshme.

Standardi ofron një perspektivë elastike në shumë nivele për projektet ZBN dhe mjediset e tyre mundësuese, bazuar në 8 kritere dhe tregues shoqëruës (shih Figurën 1). Kjo Përmbledhje e Politikave paraqet tre kritere të përfshira në Standard me rëndësi të veçantë për qeverisjen. Për secilin kriter, janë paraqitur raste studimore për të ilustruar zbatimin e tyre dhe mënyrën se si ato kanë funksionuar në praktikë.




Figura 1. 8 Kriteret e Standardit Global të IUCN-së për Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (© IUCN).

Mesazhi kyç: ZBN-të duhet të bazohen në qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe fuqizuese (Kriteri 5)

“Qeverisja gjithëpërfshirëse” në Standard synon të sigurojë që ZBN-të të përfshijnë dhe t'u përgjigjen shqetësimeve të të gjithë palëve të interesuara të prekura drejtpërdrejt dhe tërthorazi, dhe veçanërisht mbajtësve të të drejtave, pavarësisht nga gjinia, mosha apo statusi social, dhe të mbrojnë të drejtat e popujve indigjenë. Qeverisja e një ndërhyrjeje ZBN ofron mundësi për përfshirje në

identifikimin, projektimin, vendimmarrjen, monitorimin dhe reagimet, dhe proceset e ankesave për të gjithë aktorët, me vëmendje të kujdesshme dhe mbështetje për të siguruar përfshirjen e atyre që zakonisht janë të privuar nga e drejta, të cilat shpesh përfshijnë gratë, komunitetet vendore dhe popujt indigjenë. Përfshirja veçanërisht e grupeve tradicionalisht të përjashtuara në marrëveshjet e qeverisjes do të mbështesë përputhshmërinë e ZBN-ve. Angazhimi kuptimplotë i këtyre grupeve jo vetëm që do të rrisë ndërgjegjësimin e tyre mjedisor dhe socio-politik, por gjithashtu do t'i përfshijë ata në vendimmarrje, gjë që do të kontribuojë thjesht në ndarjen e përfitimeve mjedisore, sociale dhe ekonomike, qëndrueshmërinë afatgjatë të ZBN-ve dhe në ndërtimin e aftësisë ripërtëritëse të komunitetit.

Meqenëse pjesëmarrja e publikut është një komponent kyç i qeverisjes gjithëpërfshirëse, “përfshirja” shkon përtej thjesht mundësimit të qasjes së informacionit nga publiku. Përpjekjet aktive për të qenë gjithëpërfshirës kërkojnë të kuptuarit e shumëllojshmërisë së popullsisë në një gjeografi që synohet nga një projekt, dhe që përfshin, p.sh., analizat gjinore, për të kuptuar nevojat e ndryshme të popullsisë dhe mënyrat e ndryshme që ata qasin dhe përdorin informacionin. Përpjekje të tilla janë thelbësore për të ditur se si të përfshihen perspektivat në mënyrë sa më të drejtë. Për shembull, në Serbi, përpjekjet e fundit për të zhvilluar masat ZBN të Restaurimit të Peizazhit Pyjor në nivel vendor përfshinin në mënyrë të qartë një analizë gjinore për identifikimin dhe hartimin e këtyre masave (shih Kutinë 1) (IUCN, 2021).

Kutia 1. Analiza gjinore për identifikimin e masave të Restaurimit të Peizazhit Pyjor në Kraljevo, Serbi

Një nismë e kohëve të fundit e IUCN-së në Serbi synonte hartimin e masave për restaurimin e peizazhit pyjor (RPP) në komunën serbe të Kraljevos. Analiza gjinore ishte një pjesë thelbësore e qasjes së identifikimit të masës RPP (IUCN, 2021). Nisma zbatoi Metodologjinë e Vlerësimit të Mundësive të Restaurimit (MVMR), e cila përfshiu një analizë gjinore në studim

për të identifikuar preferencat dhe ndikimet e ndryshme të masave të ndryshme të RPP-së për gratë, si dhe grupet e tjera që mund të jenë të cenueshme dhe të marginalizuara.

Objektivat e analizës gjinore ishin:

- të vlerësojë mënyrat dhe shkallën në të cilën gratë dhe grupet e tjera të cenueshme janë të prekura nga privimi social dhe ekonomik dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe rreziqet nga fatkeqësitë, dhe si mund të adresohen këto me masa të ndryshme RPP;
- të eksplorojë normat dhe rolet mbizotëruese gjinore dhe mënyrën se si ato lidhen me masat dhe aktivitetet e mundshme të RPP-së, veçanërisht në lidhje me qasjen e informacionit, aftësinë për të qasur përfitimet e projektit, duke përfshirë punësimin; dhe
- të rrisë integrimin e qasjeve të përgjigjshme gjinore dhe kapaciteteve përkatëse në aktivitetet e lidhura me RPP-në dhe ZBN-të.

Gjetjet për çështjet gjinore:

- Stereotipet gjinore janë ende shumë të forta, dhe gratë janë kujdestaret kryesore për fëmijët dhe të moshuarit dhe ato kryejnë shumicën e punës së papaguar, veçanërisht në familjet në zonat rurale.
- Pozita ekonomike e grave është e pafavorshme dhe shpesh burrat janë vendimmarrësit kryesorë dhe siguresit kryesorë në familje.
- Gratë në Kraljevo kanë më pak mundësi të punësohen sesa burrat dhe marrin pjesë më pak në vendimmarrje, gjë që lidhet me format e prodhimit bujqësor dhe rolet gjinore të familjes.
- Për gratë, ekziston një nevojë strategjike për rritje të njohurive dhe rrjeteve, transportit dhe shërbimeve sociale të disponueshme, dhe një nevojë e veçantë për qasje më të madhe në teknologjinë e prodhimit bujqësor.
- Politikat përqendrohen kryesisht në përmirësimin e pozitës së grave rurale nëpërmjet mbështetjes financiare për prodhimin bujqësor, zhvillimin e turizmit dhe rrjetëzimin.

Rekomandimet e analizës gjinore:

- Gratë duhet të përfshihen në të gjitha fazat e procesit, duke përfshirë takimet dhe konsultimet publike. Përveç kontributeve të vlefshme, dukshmëria e pjesëmarrjes, njohjes dhe fuqizimit të tyre do të kontribuojë në tejkalimin e stereotipeve gjinore.
- Gratë duhet të konsultohen për llojet e farave dhe specieve dhe masat shitesë në mënyrë që të rriten përfitimet e mundshme nga ZBN-të.
- Brenda ndërhyrjes mund të sigurohen përfitime shitesë për gratë, si panele diellore ose burime të tjera të rinovueshme të energjisë për të ndriçuar pjesët e pasigurta të fshatit.
- Aktivitetet e komunitetit në lidhje me burimet natyrore ose pyjet duhet të projektohen për të shfrytëzuar perspektivat dhe njohuritë unike të grave dhe për të mbështetur rrjetëzimin e tyre.

Analiza gjinore është me të vërtetë një komponent kyç i qeverisjes gjithëpërfshirëse dhe themeli i një qasjeje gjithëpërfshirëse të përgjigjshme gjinore. Ajo eksploron rolet dhe marrëdhëniet midis njerëzve të gjinive të ndryshme, si dhe mundësitë e veçanta gjinore, pengesat dhe autoritetin vendimmarrës. Analiza gjinore mundëson të kuptuarit e dallimeve gjinore dhe diskriminimit sistematik që duhet të adresohen për të përparuar në drejtim të barazisë gjinore. Me këtë njohuri, masat ZBN mund të planifikohen dhe zbatohen në mënyra që njohin rolet dhe dinamikat gjinore duke trajtuar normat dhe praktikat diskriminuese.

Normat shoqërore dhe dinamikat e pushtetit janë shumë të veçanta për kontekstin, dhe si të tilla, është e nevojshme që proceset e analizës pjesëmarrëse të projektohen me kujdes dhe ndjeshmëri në mënyrë që të kapërcehen supozimet dhe të sfidohen perceptimet që paraqesin pengesa për barazinë gjinore. Për shkak se rolet dhe marrëdhëniet gjinore ndryshojnë me kalimin e kohës dhe sipas rrethanave, analiza gjinore duhet të organizohet si një proces i vazhdueshëm që mund të informojë monitorimin dhe vlerësimin përmes një qasjeje përshtatëse të menaxhimit (Kriteri

7) që promovon të nxënit dhe përshtatet me kalimin e kohës. Për të siguruar këtë, është e rëndësishme që të fuqizohen institucionet vendore, duke përfshirë grupet e grave dhe përfaqësuesit e tjerë të grupeve të përjashtuara nga shoqëria, për të promovuar kapacitete të mjaftueshme vendore për të adresuar këto çështje ndërkohë që zhvillohet ndërhyrja ZBN.

Është e rëndësishme të theksohet se, përveç argumenteve të drejtësisë sociale për qeverisjen gjithëpërfshirëse, dëshmitë e fundit empirike mbi ZBN-të tregojnë gjithashtu se qeverisja gjithëpërfshirëse dhe transparente është çelësi për rezultate efektive dhe të qëndrueshme për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Për shembull, një rishikim i kohëve të fundit i ZBN-ve urbane që synojnë rizhvillimin e gjelbër zbuloi se qeverisja me pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirëse mund të përmirësohet përmes procesit të projektimit dhe zbatimit për mbledhjen dhe analizën e të dhënave që angazhojnë në mënyrë aktive qytetarët dhe rrisin ndërgjegjësimin e tyre për çështjet e trajtuara nga ZBN-të. Në të vërtetë, po shfaqen qasjet e shkencës qytetare që përfshijnë zhvillimin e 'platformave qytetare' në të cilat të dhëna të rëndësishme për klimën ose rrezikun mjedisor mund të vihen në dispozicion dhe kështu përveç që shërbejnë si një burim analitik, shpesh rezultojnë efektive në rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për vlerën e natyrës urbane dhe rritjes së angazhimit të tyre me nismat për mbrojtjen dhe restaurimin e natyrës urbane (Hawxwell dhe et al, 2018).

Ekzistojnë një sërë mjeteve të reja dhe novatore për të mbështetur një qeverisje të tillë gjithëpërfshirëse përmes formave të ndryshme të angazhimit dhe bashkëprodhimit me palët e interesuara. Për shembull, një zbatim i kohëve të fundit i ZBN-ve në zonat e demonstrimit në Danubin e Poshtëm dhe në Slloveni krijoi një 'sistem monitorimi të bazuar në komunitet' i cili mundëson rritjen e ndërgjegjësimit midis pjesëmarrësve, si dhe gjenerimin e njohurive që u përdorën në vendimmarrjen e projektit për të rritur performancën e përgjithshme të ZBN-ve në lidhje me treguesit kryesorë të performancës. Një rishikim i projektit zbuloi se i gjithë procesi i "përcaktimit të përbashkët të përfitimeve dhe përfitimet e përbashkëta, përcaktimi i treguesve dhe projektimi

[sistemi i monitorimit të bazuar në komunitet] - kontribuoi në ndërgjegjësimin e palëve të interesuara të përfshira në gamën e gjerë të përfitimeve që mund të prodhohen përmes zbatimit të ZBN-ve” (Giordano, R. et al., 2019).

Mesazhi kyç: Projektimi i ZBN-ve duhet të përfshijë nevojën për të balancuar kompromiset (Kriteri 6)

Qëllimi i kriterit 6 "Balancimi i kompromiseve" në Standard është të sigurojë që përkrahësit e ZBN-ve të pranojnë kompromiset dhe të ndjekin një proces të drejtë, transparent dhe gjithëpërfshirës për t' i balancuar dhe menaxhuar ato si në kohë ashtu edhe në hapësirën gjeografike (IUCN, 2020). Kompromiset ndodhin sepse ZBN-të shpesh ofrojnë një shumëllojshmëri përfitimesh të ndryshme dhe jo të gjithë palët e interesuara i vlerësojnë këto përfitime në të njëjtën mënyrë. Kompensime të tilla janë të natyrshme në menaxhimin e burimeve natyrore, veçanërisht kur përfshihen aktorë të shumtë me preferenca të ndryshme dhe nivele të ndryshme kompetencash. Për shembull, ndërsa operatorët turistikë në zonat rurale mund të favorizojnë përfitimet e ujit të pijshëm të pastër, palët e tjera të interesuara mund të favorizojnë maksimizimin e prodhimeve bujqësore dhe këto dy rezultate mund të bien ndesh. Një shembull tjetër i lidhur me politikën klimatike do të ishte një masë e madhe pyllëzimi me monokulturë për të zbutur CO₂ e cila ndikon negativisht në biodiversitetin dhe burimet ujore.

Identifikimi dhe shqyrtimi i kompromiseve ndërmjet aktorëve të shumtë, dhe diskutimi për ndërhyrjet e mundshme kompensuese mund të zvogëlojë konfliktet dhe të rrisë efektivitetin afatgjatë të ZBN-ve. Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet se kompromiset e tilla mund të bëhen një çështje madhore kur ato zgjidhen në të njëjtën mënyrë disa herë, për shembull, duke i dhënë përparësi në mënyrë të vazhdueshme prodhimit bujqësor mbi ruajtjen e biodiversitetit, në mënyrë që përfitimet kryesore

të ekosistemit të zvogëlohen ndjeshëm gjatë një ekosistemi të tërë ose shkalle të peizazhit, ose duke bërë që popullsia të veçanta të jenë vazhdimisht në disavantazh ose të përjashtuara. Grupe të ndryshme të interesit që shpesh lihen jashtë – për shembull, gra dhe komunitete të ndryshme indigjene – mund të kenë gjithashtu qasje të pabarabartë në proceset e vendimmarrjes dhe shkëmbimit të informacionit që zbehin përfundimisht aftësinë e tyre për të ndikuar, për të përcaktuar dhe për të përfituar nga vendimet e kompromiseve. Shqyrtimi i kompromiseve dhe mënyra e zgjidhjes së tyre duhet t'i marrë parasysh këto rreziqe dhe të përfshijë masa mbrojtëse të përgjigjshme ndaj gjinisë, shoqërore dhe të orientuara nga komuniteti për të shmangur rezultate të tilla negative. Për shembull, përvojat e fundit në Serbi për zhvillimin e masave të Restaurimit të Peizazhit Pyjor (RPP) trajtuan gjithashtu çështjen e kompromiseve në përzgjedhjen e masave të RPP-së, pasi metodologjia e vlerësimit të RPP-së pranoi se komponenti i peizazhit vlerësohet në mënyra të ndryshme nga palë të ndryshme të interesit. Projekti adresoi këto kompromise duke kombinuar masa të ndryshme RPP në zonën e ndërhyrjes dhe duke përfshirë palët e interesuara vendore në zgjedhjen e zonave të veçanta për t'i dhënë përparësi bujqësisë së qëndrueshme, pylltarisë së qëndrueshme apo një ndërthurje të të dyjave (IUCN, 2021).

Marrja në konsideratë e kompromiseve duhet të përfshijë masa mbrojtëse sociale dhe ekologjike për të siguruar ruajtjen e standardeve minimale të sigurisë. Analizat sociale të komunitetit, duke përfshirë analizat gjinore, sigurojnë se ekzistojnë masa minimale mbrojtëse sociale dhe se ofrohen standarde minimale të kujdesit (shih Kutinë 1 mbi Analizën Gjinore). Masat mbrojtëse ekologjike duhet të përcaktohen përmes analizave të kontekstualizuara të ekosistemit ose peizazhit për të përcaktuar caqet kryesore dhe për të siguruar që masat mbrojtëse të mos tejkalohen. Masat mbrojtëse janë të nevojshme për të siguruar që caqe të tilla të mos shkelen, për shembull, nga praktikrat intensive të përdorimit industrial të tokës, dhe që vetitë stabilizuese afatgjata të ekosistemit të mbeten të paprekura. Një numër zhvillimesh të fundit në qasjet analitike trajtojnë pikërisht këtë çështje të kompromiseve për ekosistemet dhe mund të mbështesin projektimin e ZBN-ve (shih Kutinë 2).

Kutia 2. Mjetet e vlerësimit të kompromiseve ekonomike dhe natyrore për projektimin e ZBN-ve: ZBN-të për përshtatjen ndaj rritjes së nxehetësisë urbane

Një mjet për të eksploruar në mënyrë analitike kompromiset dhe masat mbrojtëse për projektimin e ZBN-ve është InVEST (Vlerësimi i Integruar i Shërbimeve dhe Tregtisë së Ekosistemit), i cili është një koleksion modelesh të softuerëve me burim të hapur që përdorin të dhëna hapësinore dhe analiza për të vlerësuar mallrat dhe shërbimet nga natyra në një varg shkallësh dhe vendndodhjesh (Guerry et al., 2021). InVEST synon të mbështesë vendimmarrësit në eksplorimin e ndryshimeve në ekosisteme dhe efektet e tyre në rrjedhat e përfitimeve të ndryshme për njerëzit (Chaplin-Kramer et al., 2019). Duke pasur parasysh aftësinë e tij për të adresuar shërbime të shumta të ekosistemit nëpër mjedise të ndryshme, InVEST ofron një mjet për vlerësimin transparent të kompromiseve ndërmjet qëllimeve të ndryshme mjedisore dhe ekonomike si për të mbështetur vendimmarrës të ndryshëm, ashtu edhe për të mundësuar një diskutim më të gjerë të këtyre kompromiseve, dhe masat e mundshme mbrojtëse të nevojshme ndërmjet palëve të ndryshme të interesit. Modelet e InVEST përdorin sistemet e informacionit gjeografik (GIS) dhe mund të prodhojnë rezultate përgjatë treguesve biofizikë (p.sh., shkallëve të ftohjes urbane), treguesve ekonomikë (p.sh. kostove të shmangura të ftohjes) dhe treguesve të tjerë social (p.sh., ndryshimeve në vdekshmëri/sëmundshmëri) (Guerry et al., 2021). InVEST mund të aplikohet për të vlerësuar shërbimet e ekosistemit urban në lidhje me një sërë sfidash shoqërore që lidhen me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke përfshirë ftohjen urbane, zbutjen e përmytjeve, zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe shëndetin mendor dhe fizik.

InVEST është aplikuar në një sërë mjedisesh për të informuar përgjigjet ndaj rritjes së nxehetësisë në qytete përmes ftohjes urbane. Ndërsa qytetet në nivel global janë gjithnjë e më të ekspozuara ndaj temperaturave në rritje dhe valëve të të nxehtit, reduktimi i rritjes së nxehetësisë urbane po kthehet në një prioritet në axhendën e politikave urbane. Gjelbërimi i zonave urbane nëpërmjet bimësisë është një masë e rëndësishme për të adresuar këto rreziqe, pasi siguron hije, rrit ftohjen nëpërmjet avullimit dhe modifikon vetitë termike të mjedisit urban. Masa të tilla mund të zvogëlojnë efektet e ishujve të nxehetësisë urbane dhe të kenë përfitimet e përmirësimit të shëndetit dhe mirëqenies për komunitetet urbane. Në të vërtetë, ulja e vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë dhe rehatia dhe produktiviteti më i madh shoqërohen me reduktimin e ishujve të nxehetësisë urbane (Guerry et al. 2021). Modeli i ftohjes urbane InVEST integron hijen, avullimin, përthyerjen e dritës dhe distancën nga ishujt ftohës (p.sh. parqet) për të zhvilluar një indeks të zbutjes së nxehetësisë. Më pas, indeksi mund të përdoret për të gjeneruar vlerësime në lidhje me efektet e uljes së temperaturës nga masat e bimësisë në mjediset urbane. Si hap i fundit analitik, InVest më pas aplikon një nga dy metodat opsionale të vlerësimit për të vlerësuar vlerën e përfitimeve të zbutjes së nxehetësisë bazuar në konsumin e energjisë dhe produktivitetin e punës. Duke krahasuar masat e rritjes së bimësisë me një gjendje fillestare pa gjelbërim, InVest mbështet llogaritjen e përfitimeve që rrjedhin nga ftohja shtesë e ofruar nga skenarë të ndryshëm, duke mbështetur qytetet në vlerësimin e përqindjes së fitimit ose humbjes në ofrimin e shërbimeve nga masat e gjelbërimit (Guerry et al 2021). Llogaritja e përfitimeve sipas skenarëve të ndryshëm mund të përdoret për të vlerësuar kompromiset ndërmjet investimeve në masat e gjelbra urbane dhe opsioneve të tjera investuese (p.sh. infrastruktura konvencionale ose pa investim), përgjatë treguesve të përcaktuar biofizikë, ekonomikë dhe socialë.

Mesazhi kyç: Projektimi i ZBN-ve duhet të përfshijë marrjen parasysh të përfshirjes dhe qëndrueshmërisë (Kriteri 8)

Në mënyrë që efektet e masave të ZBN-ve të shkallëzohen, ekziston nevoja për marrëveshje qeverisjeje që mundësojnë që rezultatet e ZBN-ve të ndikojnë në mjedisin më të gjerë të politikave. Qëllimi i Kriterit 8 "Përfshirja dhe qëndrueshmëria" në Standard është të mundësojë këtë ndikim duke siguruar që ZBN-të të jenë në përputhje me kornizat e tjera të politikave përkatëse dhe se proceset e komunikimit dhe të të nxënit të jenë në zbatim për të integruar rezultatet dhe përvojat e ZBN-ve në peizazhin më të gjerë të politikave.

Të dy aspektet ndihmojnë për të siguruar që rezultatet të zgjasin përtej kornizës kohore të kufizuar të një ndërhyrjeje të posaçme ZBN. Së pari, përafrimi i ZBN-ve me politikat ekzistuese është kritik për të siguruar ndikimet afatgjata të ZBN-ve si në sektorë (p.sh. pylltari ose bujqësi), ashtu edhe në politikat dhe proceset e ndërlidhura socio-kulturore dhe ndër-sektoriale (p.sh., për të siguruar përparimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave ose për të adresuar varfërinë shumëdimensionale) duke siguruar që rezultatet e ZBN-ve të kontribuojnë në objektivat e politikave në këto fusha. Për një analizë të mjedisit të politikave mundësuese për ZBN-të në Ballkanin Perëndimor shih (Bisaro dhe Meyer, 2022).

Së dyti, krijimi i proceseve të komunikimit dhe të të nxënit për integrimin e ZBN-ve është veçanërisht i rëndësishëm sepse ZBN-ja është një koncept në zhvillim dhe shkëmbimi i hapur i informacionit dhe përvojave mbi ZBN-të mund të rrisë të nxënit dhe të stimulojë kërkesën dhe drejtimin e ZBN-ve midis aktorëve të shumtë. Promovimi i proceseve të tilla të të nxënit në ZBN mund të krijojë një cikël të virtytshëm ku projektimi i ZBN-ve përmirësohet bazuar në mësimin dhe shkëmbimin e përbashkët, i cili nga

ana e tij rrit kërkesën e përgjithshme për ZBN-të e mëtejshme në fusha të ndryshme politikash, sepse rezultatet e ZBN-ve shihen si efektive, të përballueshme dhe të qëndrueshme. Ky është veçanërisht rasti kur, nëpërmjet shkëmbimeve të tilla, ZBN-të harohen dhe zbatohen në qasje që janë plotësuese me strukturat ekzistuese institucionale, politikat, planet, ligjet, rregulloret dhe ndërhyrjet e tjera përkatëse. Duke pasur parasysh diskutimin e mësipërm mbi Kriterin 5, ZBN-të duhet të përfshihen në mënyrë që ato të lehtësojnë marrjen e mëtejshme të ZBN-ve të bazuara në të drejta, të përgjigjshme ndaj gjinisë në kornizat e politikave mundësuese.

Për përafrimin e politikave, kjo nënkupton që ZBN-të për përshatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë duhet të kontribuojnë në marrëveshjet globale, qëllimet dhe angazhimet për zhvillim të qëndrueshëm. Për integrimin e përvojave ZBN, ekzistojnë qasje të ndryshme të cilat në përgjithësi mbështeten në komunikimet strategjike dhe shtrirjen. Audiencat kryesore që mund të jenë më të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë janë individët (publiku, akademikët), institucionet (qeveria kombëtare, bizneset fillestare, organizatat joqeveritare) dhe rrjetet globale (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Marrëveshja e Parisit) (IUCN, 2020).

Përveç shtrirjes në terren, është e rëndësishme që politika për rritjen dhe integrimin e ZBN-ve të adresojë nevojat për ndarjen e njohurive, bashkëpunimin, të nxënit dhe ngritjen e kapaciteteve. Në veçanti, politika që synon integrimin e ZBN-ve duhet:

- Të rrisë **ndërgjegjësimin e publikut**, për shembull përmes seminareve, dialogëve dhe platformave online, për përvojat e fituara përmes projekteve pilot dhe demonstrimit se ZBN-të krijojnë me sukses përfitime të shumta të përbashkëta, veçanërisht nga grupe të ndryshme njerëzish dhe për ta;
- Të sigurojë kohën dhe hapësirën e mjaftueshme për **bashkëpunim** ndërmjet grupeve të ndryshme të aktorëve të nevojshëm për të planifikuar dhe zbatuar ZBN-të novatore (p.sh. qeveritë, biznesi dhe industria, studiuesit, investuesit, financuesit, OJQ-të, grupet e komunitetit si rrjetet dhe kooperativat e grave dhe OSHC-të);

- Të sigurojë **trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve** (p.sh., për teknologjinë, menaxhimin financiar) aty ku është e nevojshme për të siguruar që palët e ndryshme të interesit të jenë në gjendje të ndikojnë, zbatojnë dhe përfitojnë nga ZBN-të për një afat të gjatë;
- Të marrë parasysh **kontekstin** brenda të cilit zbatohen ZBN-të, duke pranuar se shumica e zgjidhjeve varen nga konteksti dhe mund të nevojiten rregullime në mënyrë që ato të funksionojnë në kushte të ndryshme politike, ligjore, socio-kulturore dhe natyrore. Mjete të tilla si analizat gjinore ndërsektoriale mund të ndihmojnë;
- Kudo që është e mundur, të sigurojë që popullsia vendase të **bashkëinvestojë** (qoftë financiarisht ose nëpërmjet angazhimeve në natyrë) në ZBN për të siguruar pronësinë e zgjidhjes;
- Të mundësojë **mobilizimin e buxheteve të dedikuara për ZBN-të**, dhe në këtë mënyrë të koordinohet ngushtë me Ministrinë e Financave.

Referencat

- Bisaro, A., Meyer, K., 2022. Integrating Nature-based Solutions into Policies for Climate Change Adaptation and Disaster Risk Reduction. A Regional Comparative Policy Analysis in the Western Balkans (ADAPT project). IUCN.
- Giordano, R. et al., 2019. Deployment of the community-based monitoring system and implementation of the platform. NAIAD Project Deliverable 3.4.
- Hawxwell, T., et al., 2018. D6.2 Municipal Governance Guidelines | UNaLab. UNALAB.
- IUCN, 2021. Forest Landscape Restoration Opportunities Assessment, Municipality of Kraljevo, Serbia. IUCN ECARO.
- IUCN, 2020. IUCN Global Standard for Nature-based Solutions : first edition.
- Seddon, N., Daniels, E., Davis, R., Chausson, A., Harris, R., Hou-Jones, X., Huq, S., Kapos, V., Mace, G.M., Rizvi, A.R., Reid, H., Roe, D., Turner, B., Wicander, S., 2020. Global recognition of the importance of nature-based solutions to the impacts of climate change. Global Sustainability 3. <https://doi.org/10.1017/sus.2020.8>

Burime të mëtejshme

- Restoration Opportunities Assessment Methodology (ROAM): <https://www.wri.org/research/restoration-opportunities-assessment-methodology-roam>
- United Nations Environmental Assessment (UNEA) resolution on Nature-based Solutions: <https://wedocs.unep.org/bitstream/handle/20.500.11822/39864/NATURE-BASED%20SOLUTIONS%20FOR%20SUPPORTING%20SUSTAINABLE%20DEVELOPMENT.%20English.pdf?sequence=1&isAllowed=y>



Ky material u përgatit në kuadër të projektit ADAPT: Zgjidhje të Bazuara në Natyrë për Shoqëritë me Aftësi Ripërtëritëse në Ballkanin Perëndimor. ADAPT është një nismë tre vjeçare e financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim në Zhvillimin Ndërkombëtar (SIDA), e zbatuar nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), Zyra Rajonale për Azinë Qendrore dhe Evropën Lindore (ECARO). Qëllimi i projektit është të rrisë aftësinë ripërtëritëse të ekosistemeve dhe komuniteteve ndaj ndryshimeve klimatike dhe të zvogëlojë rrezikun nga fatkeqësitë duke zbatuar Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë në Ballkanin Perëndimor.



This material/production has been financed by the Swedish International Development Cooperation Agency, Sida. Responsibility for the content rests entirely with the creator. Sida does not necessarily share the expressed views and interpretations.